

## Procesverbal

*Nga mbledhja e IV- (katërt) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:  
27.04.2023*

### *Rend Dite*

- 1) Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (II dhe III),
- 2) Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën Janar – Mars 2023,
- 3) Propozim Vendim për Emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Dragashit,
- 4) Propozim vendim për korrigjimin në Regjistrin Kadastral....
- 5) Propozim Vendim për Emërimin e komisionit për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim të Pronës se Paluajtshme të Komunës,
- 6) Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të patundshmërisë Komunale P-70604038-00244-2 Z.K. Shajne I,
- 7) Eventuale...

**Uran Halimi:** Përshëndetje të nderuar, mirë se keni ardhë në mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ku njëherit është propozuar ky rend i ditës: në pikën e parë e kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara II dhe III, pika e dytë me radhë është Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën Janar – Mars 2023, pika e tretë: Propozim Vendim për Emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Dragashit, te pika e katërt e kemi Propozim vendimin për korrigjimin në Regjistrin Kadastral, pika e pestë është Propozim Vendimi për Emërimin e komisionit për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim të Pronës se Paluajtshme të Komunës, e gjashta me radhë është Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të patundshmërisë Komunale, është fjala për parcelën me numër 70604038-00244-2 në Shajne, edhe pikën e shtatë edhe të fundit e kemi pikën eventuale. Para se ta hedhim në votim rendin e ditës, unë ju ftoj nëse dikush do me e marrë fjalën? Fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdilar dhe pas tij z.Artan Loshaj.

**Nedžmidin Sejdilar:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nuk e di nëse e dini se SHF Fetah Sylejmani sot feston ditën e shkollës. Ndoshta pushtetit ekzekutiv i ka ikur dhe nuk i kanë kujtuar datat e rëndësishme në komunën tonë. Duke qenë se aty ka festë, sugjeroj që kjo seancë të shtyhet deri në orën 12:00 dhe të shkojmë të gjithë atje.

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Unë si delegate i Kuvendit e kam edhe një kërkesë nga ju, të nderuar delegatë. Kërkesa është për një kërkesë që ka ardhur në Zyrën e Kuvendit, është e protokolume, është për një investim shumë i madh, por në...këtë e kam kërkuar edhe dje në KPF, në rend dite nuk e ka prur kryetari i Komunës dhe kryesuesi. Andaj, sot kërkoj nga ju që të më

mundësohet, si pikë e rendit të ditës të diskutohet, vetëm diskutimi, jo votimi, që të njoftonu për këtë investim dhe pastaj është e juaja a ma jepni të drejtën, a më mbështetni për me kërkue ni seancë të jashtëzakonshme, ose me propozim të kryetarit, të delegatëve edhe të kryesuesit të... bare së paku në seancën tjetër të jetë në rend dite, sepse bahet fjalë për ni investim shumë gjigant, shumë të madh. Tash ju e dini, në qoftë se keni durim mudi edhe me... fjalimin, pse, më ju tregue deri në fund çka bëhet fjalë, mirë, në qoftë se jo atëherë unë kërkuj nga ju që të më mbështetni, si pikë e rendit të ditës vetëm për diskutim, e pastaj kur të vjen pika e rendit të ditës unë do të ju jap sqarime ma gjerësisht. Përndryshe, në qoftë se nuk më mbështetni, unë e kam edhe pikën eventuale, prapë do t'jau thom këtë dhe t'ju njoftoj. Është mirë, për hir të transparencës dhe për hir...se kryetari i Komunës kur ka ardhë në pushtet ka thonë që na jemi transparentë dhe të gjitha kërkesat do të shqyrtohen njëjtë si çdo qytetar. Këtu nifarë dallimi e ka bo, dikuj i shtihet në rend dite, dikuj jo domethënë. Falemnderit! ...A ka nevojë a s'ka nevojë, i nderuar delegat, ti mundish me votë me e shpreh, përndryshe e drejtë e jemja si delegat i Kuvendit Komunal, e kam të drejtë me lyp edhe ky Kuvend mos ma merrni të drejtën e diskutimit edhe të fjalës, se kurrë 14 vjet s'ta kam marrë këtë të drejtë. E drejtë e jemja është me kërkue edhe e drejtë e jotja është me votue për apo jo. Veç është mirë, si delegat po të bëj ftesë ty, me dëgjue problemin, mos më ndërhyj, është me dëgjue edhe e juaja është me votue, domethënë e drejtë e jemja është me kërkue. Falemnderit! Po, po more patjetër, patjetër, unë jau sqaroj. A keni durim a jo? Qashtu. Të nderuar delegatë, unë sot do të diskutoj për një kërkesë nga një investitor që i ka drejtuar Kuvendit të Komunës së Dragashit dhe kryetarit të Komunës, ku është e protokoluar më datën 12.04.2023. E kreva. A vazhdojmë? Falemnderit! Seanca është caktuar më 14.04.2023 dhe nuk është në rend dite, domethënë sot kjo kërkesë nuk është në rend dite. Dje në Komitet e kam kërkuar kërkesën nga kryetari dhe kam kërkuar sqarim, se pse nuk është futur në rend dite. Kryetari deklaroi se më shumë se një hektar nuk mund të japë, për arsye se pas pesë apo dhjetë viteve mos rastësisht lajmërohet dikush, ndonjë investitor tjetër. Kjo është veç imagjinatë e kryetarit, qetash na pas pesë vjete ose dhjetë vjete s'e dijmë a jemi gjallë a jo, e do të vjen ndonjë investitor, a na duke e pas investitorin këtu. Unë i bëj thirrje kryetarit se vetëm le të vijnë investitorë, se vend kemi plot për investime, si në zonë industriale në Shajne, si zona...në pikën e katërt ose të pestë e kemi, te Pllava, 14 parcela, vend kemi plot, veç ju lutem bini investitorë, thirrni investitorë edhe s'ka problem. Të nderuar delegatë, kërkuj që ta merrni seriozisht këtë kërkesë, sepse në qoftë se e japim pëlqimin, do të investohet në një shumë të madhe, ku e keni në dokumente se do të punësohen mbi 50 punëtorë. Këto dokumentacione krejt i keni në Zyrën e Kuvendit. Pse nuk e ka pru kryesuesi dhe kryetari për diskutim, në qoftë se jeni të interesuet është atje, është Plani i Punës, janë të gjitha të qitme aty. Do të punësohen mbi 50 punëtorë, nëse kërkesa e jonë, e tij, realizohet tek ne pozitivisht, është në dokumentacion që 2% e totalit të bruto produktit do të shkojë në llogari të Komunës së Dragashit dhe 1% do të shkojnë në llogari të fshatrave ku rrethohet ajo zonë ku do të investohet. Ajo do të bëhet ni kontratë me kryetarin edhe me Komunën. Në dokumentacion është i kompletuar si numri i regjistrimit të kompanisë, lista e pronës, kopja e planit, Plani i Punës, arsyetimi ekonomik, si dhe kjo komunë i ka edhe dokumentacionin që i ka dhonë personit që ka.. ose firmës që ka... është firmë amerikane që ka bo kërkesën për investim, e ka edhe dokumentacionin që nuk është i

interesuar komuna për investim, si dhe nuk është në plan urbanistik ajo parcelë ose ajo pjesë ku do të kërkohet. Të gjitha janë në Zyrën e Kuvendit. Unë kërkoj nga ju, kolegë, që të mos hezitohet, për arsye të shumta, e disa prej tyre do t'ua rikujtoj. Në vitin 2012 Komuna e Dragashit, qe ky Kuvend, pozitë-opozitë, ka investue tek MejDani në Shajne, si asfaltimin e rrugës, ujin, rrymën, vetëm për të ofruar kushte më të mira për investitorë. Qeveria e Kosovës ka bërë marrëveshje të veçantë për ngrohje solare me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim (BERZH) dhe Bankën Gjermane për Zhvillim për parkun solar 4 Kosovë. Marrëveshje të veçantë ka bërë edhe Komuna e Prishtinës, ku udhëheq LDK, Qeveria e Kosovës ku udhëheq LVV, se kryesuesi dhe kryetari dje kanë qenë kundër kësaj, marrëveshje të veçantë ka bërë edhe Komuna e Prishtinës me Bankën Gjermane për Zhvillim, projekti është 80 milionë euro grante. Ndërsa ky investitor kërkon në Dragash të investojë afër 100 milionë euro. Dhe çohet dikush nga ne edhe e kundërshton. Në rregull, po ma ka kundërshtue kryetari yt edhe kryesuesi dje në Komitet. Ju lutem, veç ta kryj! Jo, të keni durim, e kje për diskutim masnej. Kryetar, merr shembull të mirë si nga Qeveria por edhe nga kryeqyteti, a thua jemi më të mençur se ata. Ky është momenti i fundit që të reflektosh seriozisht dhe shumë urgjent që investitori mos të largohet, për arsye se që dy vite sillet për këtë projekt. KEDS i ka dhonë edhe dritën e gjelbër, i ka dhonë edhe pëlqimin KEDS-i, është edhe e dokumentume, se dje më ka thënë kryesuesi dhe kryetari nuk është e dokumentume ky material, është me numër protokoli me krejt, edhe kjo tjetra njëjtë, edhe ka pëlqimin e KEDS-it që veç pritet drita e gjelbër nga ky Kuvend, është në duart tona ky investim. Jemi komuna – e dimë shumë mirë, qetash mos të shes shumë patriotizëm – jemi komuna ma e varfër në Kosovë e në regjion, rinia po largohet çdo ditë, vende tjera pune nuk ka. E di që ndoshta e teproj, po kërkoj nga ju që të më mbështetni iniciativën time për një seancë të jashtëzakonshme, e thashë edhe ma herët, ose që jemi të pajtimit, si kryetari, kryesuesi dhe ne, që së paku në ni pikë të rendit të ditës në seancën e radhës të jetë në rend dite. Unë e kam edhe një dokument në telefon, mundni me e kqyrë, që Kosova, është një faqe zyrtare të Kuvendit, që Kosova ka bo marrëveshje 80 milionëshe, ka marrë dy projekte gjigante për energji solare, diellore, Komuna e Dragashit duke e pas investitorin në duer me e lëshue, kjo për ne është e pakapshme edhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit. Andaj kërkoj nga ju që t'i thirrjmë mendjes së shnoshë edhe ta mbështetni këtë iniciativë temen për këtë investim. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Në rregull, sa i përket kërkesës së z.Sejdilar, po, veç sa ta miratojmë rendin e ditës, kemi me shkue me marrë pjesë në atë tubim. Ndërsa, sa i përket kërkesës së z.Loshaj, meqenëse edhe më akuzoi, po due m'i kallxue që kërkesën që e ka dërgu i nderumi Shefqet Alija, nuk ka ardhë fare në Zyrë të Kuvendit, po ka shkue në Zyrë të Kryetarit. Edhe gjatë hulumtimit dje, në fakt, që e gjetëm na këtë kërkesë, unë hasa në kundërshtim se kërkesa është bërë nga z.Shefqet Alija, e diku ma vonë, dokumentacioni përcjellës është në emër të z.Fehim Salih – Kërstec. Ky emër po më përkon mu me...si i ngjofshëm edhe ma herët. E, tjetra është që në këtë kërkesë, ky e ka të njëjtën praktikë, ni ditë para seancës gjithmonë e bjer dokumentacionin e paplotësuar, në atë mënyrë që na mos të kemi hapësirë me hulumtue, mirëpo në këtë kërkesë realisht mungon Plani i Biznesit, mungon kërkesa, domethënë është kërkesa e bome në emër të Shefqet Alisë, qysh e thashë, ndërsa dokumentacioni përcjellës

është krejt në emër të dikuj tjetër. Mandej, kjo kërkesë duhet të vëhet te zyra e Drejtorisë së Urbanizmit, edhe nëse ata e konstatojnë që është një kërkesë krejt në rregull, na bien edhe neve si Kuvend që me e fut në rend të ditës, siç ka pas praktika edhe ma herët. Në këtë kërkesë mungon shuma e mjeteve që ka m'u investue, na s'dimë as çka ka m'u investue, sa është vlëra, llogaria bankare, ku janë ato pare, kah janë marrë ato pare për m'u investue këtu në komunë. E kërkon një pronë me territory kogja të gjerë, edhe thatë z.Loshaj që kjo kërkesë është bo qe dy vite, qe dy vite s'është e bome, mos vallë është fjala për atë kërkesën e hidrocentraleve dy vite. Ajo ma shumë se dy vjet bon vaki ka, mirëpo kjo kërkesa nuk i ka dy vite. Sa i përket hulumtimeve, plan edhe unë muj me bo pesëvjeçar, mirëpo... na e qesim, propozim ka me dalë në votim. Po unë e zgati, se unë nuk të thashë ty mos e zgat, unë kam të drejtë me e zgat. Tjetra është që na jemi ni zonë turistike edhe e kemi ndot këtë pjesën tonë ma herët me hidrocentrale, qetash nëse zëmë hapësira aq të gjera me panele solare, ku mbeten bizneset tjera që mundin me na ofruë diçka shumë ma të mirë. Këshu që...dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën në lidhje me këtë?

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar delegatë, mjete të informimit dhe ju të tjerë, ju përshëndes! Lidhur me kërkesën e Artan Loshajt, na kemi diskutue dje në KPF dhe ka qenë një diskutim jashtëzakonisht i gjerë, dhe ka pas edhe keqkuptime. Kryetari nuk është kundër investimeve, as kundër investitorëve, çka thajë sot, po është problemi se kërkeën të cilën e ka pru investitori, e ka pru më datën 13 edhe seanca u caktue më datën 14. Nuk ka pas kohë as me e analizue, as me me e pa atë kërkesë, edhe unë atë kërkesën e kam pa dje, e kam analizue, sot kemi pru vendim edhe e kemi çue kërkesën në Drejtoratin e Urbanizmit, kërkesa me u shqyrtue atje, me e pa. ne ma s'pari edhe nuk po e dijmë ku po lyp, 'Mejdani' po shkrun, tash te cili mejdan nuk po dihet, po megjithatë Drejtorati i Urbanizmit le ta japë mendimin e vet, atëherë na kemi kohë në asamblenë e ardhshme, nëse është çdo gjë në rregull na mujm me e shti nuk është problem, po jo me e shti si kërkesë me ia nda këtij, po me bo si kërkesë sikur kërkesat tjera, me e shpallë do te thotë atë zonë si zonë të interesit për panela solarë, e pastaj konkurojnë edhe të tjerët, edhe kush munden me marrë nuk dihet. Procedurat shkojnë kështu. Po, për momentin nuk është mirë me e votue, po megjithatë është e drejtë e juaja, se lënda ka shkue sot në Drejtoratin e Urbanizmit për me e analizue.

**Artan Loshaj:** Zoti kryetar, po më vjen shumë mirë që e ke shqyrtue këtë kërkesë, edhe po më vjen shumë mirë që e ke çue në zyrën e Urbanizmit. E incizimet, i kam lyp edhe zyrtarisht dje, ti e dish shumë mirë, edhe ti edhe kryesuesi, se e di që fjalët e mia edhe fjalët e juaja...jeni qaq të edukuet për këtë punë që i ndryshoni menjëherë. Për atë arsye unë kam kërkuë zyrtarisht dje që të më jipet incizimi në USB, edhe ta shoh çka kemi diskutue na të dy edhe ni herë të shpia. E, ju e keni bo sot me qëllim, shtatë ditë më keni prit me e marrë këtë dokument që merret për 30 sekonda, që sot mos me ta lëshue këtu. Dje ti kryetar ke thonë që këtë kërkesë nuk e kam pa. Në rregull, shumë në rregull, s'e ke pa. Dje kryetar ke thonë vetë përmi ni hektarë s'un ia abonojmë. Janë incizimet, e kemi procesverbalin, në qoftë se... në seancën tjetër e kemi procesverbalin. "Nuk mundi me dhonë më shumë se një hektarë, se mas pesë ose dhjetë viteve mund dikush me ardhë me investue." Unë prapë po të thom, veç bjer investitorë, vende kemi plot, vende kemi plot, këtu është ajo. Edhe unë nuk lypa sot me e votue, unë sot lypa me e diskutue, me ju njoftue, se ti nuk e ke bo njoftimin, me ju njoftue, edhe kërkova nga ju që në qoftë se delegatët e shohin të arsyeshme,

mas katër-pesë dite me e bo ni seancë të jashtëzakonshme, ose le të premtohet këtu që kjo pikë do të diskutohet në seancën tjetër si pikë e rendit të ditës, edhe u krye. Unë nuk lypa vendim sot me diskutue, se edhe me pas qef me diskutue nuk e keni materialin. Unë kërkova, edhe një herë po ju them, që mas 3-4 dite, qysh është zyrtarisht, mas 72 orëve mundim me majt mbledhje të jashtëzakonshme, ose premtoni që në seancën tjetër, ni muaj ditë keni, nashta Urbanizmi qaq punë nuk ka, ni muaj ditë e shqyrtoni edhe premtoni ju të dy që do ta bini në seancën tjetër, edhe tërhiqna na, s'është problem kjo punë. Po shumë në rregull doktor, edhe unë qeto p'e kërkoj, në qoftë se... ju lutem, dje më ka thonë që nuk e jap, për atë arsye unë kam dalë sot. Të kishte thonë kryetari dje që do ta çoj, do ta shqyrtoj, do ta çoj në Urbanizëm - për ni muaj ditë, 30 ditë, tri faqe nashta Urbanizmi i lexon - dhe do ta sjellë në seancën tjetër, se e kemi obligim ligjor me e pru në seancë një kërkesë të një qytetari, a tjetër send është a e mbështetim apo jo, unë e kam kërkuar veç si sqarim me pru.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Loshaj! Ni sqarim, ju lutem! Sa i përket diskutimit të djeshëm, sa i përket diskutimit të djeshëm, na kemi folë për zonën industriale në fshatin Shajne, dje kemi mendue ashtu, se s'e kemi pa kërkesën, mirëpo këtu në kërkesë krejt parcelat që kërkohen i përkasin zonës së Bellobradit. Nuk ka të bëjë me planin zhvillimor, që është t'u bo, ose të zona industriale e Shajnes. Domethënë, kërkesa për tokë nga parashtruesi i kërkesës është bërë për mejdanin e fshatit Bellobrad, mbase. Nuk ekziston këtu kërkesë për tokë në Shajne, qysh na dje e kemi diskutue. Po po, okej, fjalën e kërkoi z.Sejdilar, pas tij z.Mejzini.

**Nedžmidin Sejdilar:** Të nderuar, me sa kam kuptuar nga ky diskutim, një investitor në bashkëpunim me Fehim Saliun po kërkon të ndërtojë panele diellore në komunën tonë. Nëse kam arritur të kuptoj saktë. Dhe me këtë, ai kërkon një sipërfaqe pak më të madhe. Gjë që më shqetëson, sepse në të ardhmen do të bëhemi komunë e tensionit të lartë. Ne do të prodhojmë vetëm energji elektrike. Dhe pastaj le të vijë dikush të më shpjegojë se si të tërheqësh një investitor tjetër në një komunë ku nëse fut një lopatë mund të biesh nga rryma. Mendoj se kemi pasur shumë probleme me prodhimin e energjisë elektrike në këtë komunë. Lind pyetja, nëse të gjitha ato panele vendosen, ajo shkatërron natyrën shumë më tepër sesa tubat që vendosen përgjatë lumenjve. Unë jam i mendimit që kjo kërkesë të refuzohet menjëherë dhe që ky kuvend të marrë vendim që të mos pranojë më kërkesa për prodhimin e energjisë elektrike. skemi aq shumë natyrë për të shkatërruar.

**Sefidin Mejzini:** Kryesues, faleminderit për fjalën! Përshëndetje për të gjithë! Dëgjo koleg, qasja ke shumë e acarume, domethënë, kur e bone kërkesën, shumë i mllëfosun, edhe ti, pajtohnu të gjithë kolegët, thaje e kam pru më 13, më 14 është caktue, është një ditë. Krejt pajtohnu që për një ditë nuk mundet me hi ajo. Domethënë kërkesa ke e jote diqysh si, sa e pashë unë, po, si me urgjencë, si me inat. Kryetari doli shumë mirë, se nuk është mirë na me e votue, masnej pushteti posht, qendror – lokal, me na i kthye prapë, qysh na ka kthye shpesh. Kryetari tha i ndjekim procedurat ligjore, nuk tha që s'e bëjmë, absolut. Tash kur dole edhe herën e dytë, kogja si i mllëfosun. Unë pa të keq po ta them, kërkesa duhet m'u bo ma butë, ma... po jo, jo, po... po mirë, ti fillove menjëherë me akuza. Po s'është në rregull. Me paragjykime, s'bon, po me paragjykime, unë jam, dëgjo, unë jam ...po unë e pashë që je shumë i acarum... unë jam edhe jam konë, është

e pesta vjet, Zoti na ka falë tokën me shfrytëzue, edhe unë jam për me e shfrytëzue, në atë linjën tënde, po m' i ndjek procedurat ligjore. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Mejzini! Fjalën p' e kërkon z.Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje kryetar, kryesues i Asamblesë Komunale! Me shumë vëmendje z.Loshaj ju dëgjova. Po ishte një përgjigje shumë koncize, shumë e qartë nga kryetari aktual, dr.Bexhet Xheladini, i cili shumë qart tha se kërkesa ka shkuar deri në Drejtorinë e Urbanizmit. Drejtoria e Urbanizmit është ajo e cila jep vulën e fundit lidhur me kërkesat, me projektet të cilat, apo investitorë të huaj që dojnë të investojnë në Kosovë. Komuna jonë ka nevojë më shumë se kurrë për investime, thithje të investimeve nga gjithë bota, gjithë Evropa, që ne si komunë pra të zhvillohemi edhe më tej, edhe punësimet që përmende, e shumë gjëra të tjera. Mirëpo, ne mund t' i kemi gjykimet, paragjykimet, stereotipet e ndryshme këtu, mund të themi shumë, mirëpo ata ekspertë të fushës që punojnë dhe merren me këtë lëmi është Drejtoria e Urbanizmit. Dhe unë personalisht nuk kisha kërkuar asnjë kalim më tej, derisa të japë fjalën Drejtoria e Urbanizmit se çka do të bëhet, do të vendoset më tej. Kaq pata, faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Gashi! Fjalën e ka kërkuar z.Munir Jonuzi.

**Munir Jonuzi:** Faleminderit, nuk e kam zakon të komentoj propozimin e delegatit, por në këtë rast do të komentoj të gjithë situatën. Kjo kërkesë ka ardhur më 13/04, materialin për kuvend e kemi marrë më 14 prill. Sigurisht që nuk kishte kohë për ta futur këtë në rend dite dhe zoti Kryesues, në fund të fundit, nuk keni pse të vendosni çdo pikë në rend dite. Vlerësoni situatën, nëse kjo pikë duhet të jetë apo jo në rendin e ditës. Sidomos kur bëhet fjalë për burimet e rinovueshme të energjisë. Do të doja që ky kuvend të merrte një vendim, ashtu siç morëm për hidrocentralet. Të marrë vendim për kthimin e menjëhershëm të të gjitha kërkesave që lidhen me burimet e rinovueshme të energjisë. Ne nuk kemi nevojë për investime të tilla në këtë komunë. Kemi bërë mjaft për këtë vend. Përsa i përket burimeve të rinovueshme të energjisë i dhamë të gjithë lumenjtë. Mos i merrni tani livadhet dhe fushat tona. Kështu e fillojmë me disa kërkesa të paqarta, dje u fol për Shajne apo Plavë, e sot kërkesa thotë Bellobrad ku po shkon ky investim. Mendoj se e gjithë kjo përfundimisht do të përfundojë në Gorë dhe atje do të bëhen panele diellore. Unë do t' i kërkoja të gjithë delegatëve, ne kemi shkatërruar të gjithë florën dhe faunën, të paktën të shpëtojmë fushat, të zhvillojmë turizmin, kërkojmë investitorë për sektorë të tjerë dhe jo vetëm për burimet e rinovueshme të energjisë. Sepse e gjithë kjo më duket sikur, shkoni në komunën e Dragashit, atje jeton një komunitet joshumicë që dalëngadalë po largohet nga ky territor, që dalëngadalë po largohet nga ky vend, le të përzënë të gjithë duke instaluar fillimisht hidrocentrale, pastaj mullinjtë e erës dhe në fund panelet diellore.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Jonuzi! Fjalën e ka z.Samidin Xheladini.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm! Tash u njoftuem, unë s'kam pas dijani për këtë kërkesë, po me sa e pamë është një kërkesë e qëllime, kemi vende plotë, bjeshkët i kemi krejt të zbrazëta, edhe si të doje me investue në bjeshkë, jo tokat bujqësore, tokat e punueshme, ato nuk është mirë me i zonë, bjeshkët i kemi krejt të lira, ku të dojnë...edhe atje ia japim lejen, parku e jep lejen.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Xheladini! Meqë edhe kërkesa është dërguar në Drejtori të Urbanizmit, nap o presim nga drejtorja përkatëse që me na njoftue në lidhje me këtë kërkesë. Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën në lidhje me rendin e ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës, me këto pika që janë parapra ma herët? Kush është pro këtij rendi të ditës? Pa ndryshim, pa ndryshim, kështu si është servue. Okej, ni replikë z.Jonuzi.

**Munir Jonuzi:** Për të respektuar të gjitha procedurat, mendoj se fillimisht duhet votuar këtë propozim të Artanit dhe më pas të votojmë për rendin e ditës në tërësi. Me apo pa modifikim, varësisht nëse do të kalojë propozimi i Artanit. Më mirë të ndjekim procedurën. Një koleg delegat bëri një propozim dhe ne duhet t'i përgjigjemi atij propozimi.

**Uran Halimi:** Në rregull, ama qetash propozimi cili ke, a të diskutohet për këtë temë, apo me e shti në rend të ditës që me e marrë ni vendim na, këtu është problemi. Artan, mundish me e marrë fjalën, s'ki nevojë prej vendit. Hajde Driton.

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Çdo propozim prej çdo anëtari të Kuvendit, ti duhet me e hedhë në votim. E kie obligim për me e hedhë në votim. A kalon a s'kalon prej Kuvendit, është çështje tjetër. Masi e ke dijtë, atëherë tjera herë... shumë herë po të bon vaki.

**Uran Halimi:** Faleminderit shumë për ndihmën, z.Driton! Në rregull, atëherë nëse është kërkesa për diskutim, po e qesim në votim kërkesën e z.Loshaj. Kush është pro propozimit të z.Artan Loshaj, veç na edhe e diskutuem këtë çështje, kush është pro këtij propozimi? Kush është kundër këtij propozimi? Abstenim? Atëherë i kemi 9 vota pro, 18 kundër edhe 0 abstenim, nuk kalon propozimi i z.Loshaj. Vazhdojmë me rendin e ditës, e hedhim në votim edhe rendin e ditës. Kush është pro këtij rendi të ditës, të cilin e keni pranue në material, pa ndryshime? Kush është kundër këtij rendi të ditës? Abstenim? Kemi 18 vota pro, zero kundër edhe 9 abstenime, kalon rendi i ditës. Qetash vazhdojmë me atë kërkesën që na bënë... në rregull, po i miratojmë edhe procesverbalet, nëse s'ka dikush me diskutue në lidhje me procesverbalet, nëse po, mundeni me e marrë fjalën. A ka dikush që do me e marrë fjalën në lidhje me procesverbalet e seancave të kalume, është fjala për mbledhjen II dhe III? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbaleve? Atëherë i kemi 27 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim...më fal, 26 vota pro, kush është kundër miratimit të procesverbaleve? Abstenim? Kemi 26 vota pro, zero kundër edhe 1 abstenim, miratohet procesverbali. Ju lutem, të nderuar delegatë, p'e marrim një pauzë deri në ora 13:00, edhe kthehem në ora 13:00, po aty e kemi edhe pauzën e drekës. Qetash po vazhdojmë te manifestimi i Ditës së Shkollës, meqenëse ajo shkollë mban edhe emrin e dëshmorit të kombit, z.Fetah Sylejmani. Shihemi në ora 13:00 për vazhdimin e kësaj séance.

A jemi gati, të nderum? Nëse po, atëherë po vazhdojmë vazhdimin e seancës. Kemi mbet te pika e dytë, mas miratimit të procesverbaleve. Vazhdojmë me pikën e dytë, është Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën Janar – Mars 2023. Nëse do me e marrë fjalën dikush, ose ju ftoj t'i ftoni, m'i thirrë ata që janë jashtë edhe mundin m'u kthye në seancë. Atëherë po presim edhe nja dy minuta, derisa të kthehen anëtarët tjerë.

Atëherë po vazhdojmë aty ku e lamë, te pika e dytë, është Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën Janar – Mars 2023. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me këtë raport? Fjalën e ka kërkuë z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje të nderuar kolegë asambleistë, i nderuar drejtor! Tash, pas një pauze dy sahat po rikthehem dhe jemi pothuajse më shumë se të lodhur, por duhet patjetër që të vazhdojmë, sepse jemi këtu për qytetarët. A muj me vazhdue, a është përkthyesi aty? Atëherë do vazhdoj pak te raporti i buxhetit, të cilin e kemi materialin të ardhur nga ekzekutivi, nga kjo drejtori, për janar-mars 2023. Kam evidentuar disa lëshime apo gabime, tash në fund duhet drejtori të na tregojë se çka ka ndodhur, por së pari duhet të jam i qartë me ju, për ta kuptuar se për çka bëhet fjalë. Do të thotë gjithçka që do flas unë tash dhe krahasimet të cilat do t'i bëj unë, ju nuk mund ta kuptoni, pasi që para vetes nuk e keni raportin e shpenzimeve janar-mars 2022, e keni vetëm 2023-shin, meqë sot duhet ta diskutojmë. I nderuar drejtor! Unë do të dal direkt tek shpenzimet buxhetore 'pagat dhe shtesat'. Tek materiali i raportit të këtij viti 2023 dhe krahasimi me po të njëjtin material me vitin 2022 ndërmjet, do të thotë direkt me vitin 2022 të këtij raporti. Në raportin e vitit 2022, i cili është sjellë nga ana juaj vitin e kaluar, pagat dhe shtesat i kena pasur 1,316,169.81, ndërsa në raportin e këtij viti është sjellur viti 2022 me ndryshim, ku e kemi 1,126,250.55. Gjithçka që po flas ka të bëjë me vitin 2022. Viti 2022 që është sjellë, do të thotë në vitin e kaluar, që ka viti fiskal dhe është përmbyllë do të thotë viti 2022, dhe viti 2023 po tabela e vitit 2022, krahasimi bëhet ndërmjet dy viteve 2022-2022. Ndryshimi është tek materiali i 2023 me 2022, viti i njëjtë. Për me ta sqarue ma qartë, në raportin e vitit të kaluar, në vitin 2022, të shpenzimeve, periudha janar-mars, kemi tek pagat dhe shtesat 1,316,169.81 të evidentume, ndërsa në raportin që na është sjellë tash, materialin e sotit që e kemi këtu, viti i njëjtë, viti 2022, nuk figuron shifër e njëjtë shpenzimi, 1,316,169.81 nuk është, është 1,126,250.55. Kur të bësh krahasim me vitin 2022, do të thotë, nuk është i njëjtë. Keni bo nifarë lëshimi, nifarë gabimi. Na jemi njerëz, gabojmë, e di, atë e pranoj. Mirëpo, te këto raporte, janë të ndijshme dhe nuk e di pse u bë ky lëshim. Pres përgjigje. Kalojmë tek mallrat dhe shërbimet. Prapë e ki njëjtë, viti i njëjtë. Edhe tek mallrat dhe shërbimet, viti 2022 nuk të ërputhet me vitin 2022 tabelat të cilat na i ke sjellë në këtë material, do të thotë të vitit 2023, për të cilin sot po diskutojmë. E kie 138,998.02, ndërsa...jo, 81 mijë e ke pas në 2022-shin, në 2023 e ke qit 2022-shin 82 mijë. Prapë po të luen këtu, ku e ke bo këtë ndryshim, unë i kam gjet domethënë ku kanë ndryshue këto të dhëna, tash s'po due me i hi në detaje edhe me i potencue, pasi që është procedurë e gjatë dhe shumica prej asambleistëve as që i kuptojnë se çka ka ndodhur, për atë arsye, ti je drejtor edhe ti i kupton këto gjëra, dhe mun e gjen, është shumë e arsyeshme se keni pas mundësi ta nxjerrni raportin e vitit të kaluar, dhe atë çka po e them mund ta bëjsh direkt krahasimin dhe i vëren lëshimet që janë bo. Vazhdojmë në shpenzimet komunale, ku edhe këtu, po këtu tek viti 2022 ka qenë në rregull ndërsa viti 2021 nuk është në rregull, pasi që, në bazë të asaj që kam arritur unë ta evidentoj, të gjitha këto të dhëna të vitit 2021 të cilat kanë figuruar në raportin e shpenzimeve në vitin 2022, janë për fat të keq të bartura nga viti 2018. 2021-shi, i kie të bartura prej vitit 2018. Janë gabim. Pastaj vazhdojmë te subvencionet dhe transferet, edhe këtu e kishe botë njëjtin lëshim do të thotë, në vitin 2021 janë ta bartura të njëjtat të vitit 2018. Këtu është bo ni gabim kur ke bo bartjen dhe krahasimin e tabelave, janë ngatërrue apo çka ka ndodhë nuk po muj e di. Mundish me ma dhonë ni shpjegim... i kam në detaje, nuk po hyj në detaje se shumë gjatë shkon. Vazhdojmë, pastaj prapë tek përmbledhja e shpenzimeve, prapë këtu nuk përputhen tabelat, 2022-shi i vitit të kaluar edhe



2022-shi i këtij viti prapë do të thotë nuk është i njëjtë. Këtu veç direkt po të shkoj, tek mallrat dhe shërbimet është bërë lëshimi, edhe automatikisht tek përqindja ta lun aty dhe nuk është e njëjtë. Se e kие mallrat dhe shërbimet në vitin 2022 89,772, në 2023 po viti i njëjtë, 2022-shi do të thotë, është 81,715. Do të thotë edhe këtu është gabim. Vazhdojmë me të hyrat vetanake, viti 2022 prapë në raportin e këtij viti e kие 67,493.50, në raportin e vitit të kaluar 2022 e kие 68,503.78. Prapë këtu të luen përqindja, në krahasim me atë që tina e ke sjellë në këtë material të këtij viti. Kjo ishte ajo të cilën unë kam arrit ta evidentoj si...s'po them shkelje, po them gabim, por që besoj që nuk është dashtë të ndodhin këto gabime, se tek e fundit është shumë më lehtë të bëhet bartje e të dhënave të vitit të kaluar në vitin e ardhshëm, edhe nuk do të kishte pas problem. Tash nuk po e di se kush është përgjegjësi i rregullimit të këtij raporti të shpenzimeve dhe të vitit të kaluar. Tani është mirë do të thotë, kushdo që e ka përgjegjësinë, të del dhe të na jep pak shpjegim pse kanë ndodhë këto shkelje dhe këto gabime. Ju faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit,! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Atëherë e ftoj drejtorin, nëse ka ni përgjigje, para se ta qesim në votim këtë pikë. Po po, mundesh. Jo, s'ka pyetje tjera.

**Qamil Kolloni:** Përsëritje për të gjithë, përsëritje kryetar, kryesues, përsëritje delegatë, ju të tjerë të gjithë të pranishëm! Shpëtim, faleminderit për vërejtjet të cilat i dhatë! Realisht, është ni Sistem Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës, në të cilin nuk kanë qasje realisht drejtorët dhe të hyrat hyjnë nga ZKF dhe nga sektori i financave. Është një gjë normale, mund të jetë teknike, mund të ketë lëshim të dhënash, mirëpo qeky sistem informativ, të cilat të dhëna të fundit i nxjerrim na, është i barazuet drejtpërdrejt në aspektin digjital në vetë Ministrinë e Ekonomisë edhe Financave. Për me të dhënë sqarime detale, duhet me e bo krahasimin e vitit të kaluar edhe me marrë raportin e vitit të kaluar, për me bo edhe ni analizë edhe me pa se ku ka mund të ketë ndonjë lëshim eventual, e që është raportue në Ministri të Ekonomisë edhe Financave. Në qoftë se vërehen kësi lëshime, realisht merren vërejtje drejtpërdrejt prej lartit. Mirëpo, nuk besoj këto se ndryshojnë në pasqyrat përfundimtare edhe në pasqyrat vjetore. Këto raporte tremujore nuk besoj. Mirëpo, nuk guxon të ketë edhe kësi lëshime. Se çka ka ndodhë, ZKF shkoi me e marrë raportin e vitit të kaluar, e bëjmë një analizë, në qoftë se nuk mund të ju japim sot drejtpërdrejt ni përgjigje adekuate, sepse ata kanë qasje në këto të dhëna, nuk ka çdokush qasje, atëherë na mund të ju japim në një seancë tjetër, në mënyrë ma detale, për secilën shifër veç e veç.

**Uran Halimi:** Drejtor, para se me shkue, veç ni pyetje, qëndro aty nëse s'e kие problem, që mos me dalë edhe ni herë. Unë e kam të mallrat edhe shërbimet këtu ni pyetje, është kolona e parë, lloji i shpenzimit, shpenzimet e udhëtimit në vend, faqe numër 5, shpenzimet e udhëtimit në vend e kие vlerën nga 3,900 të 39 që ishte në vitin paraprak, qetash janë rrit në 8,359 shpenzime të udhëtimit në vend. Çka e rrokën kjo, se unë s'po e di, a nafta a çka është në pyetje, kur nafta llogaritet diku tjetër me sa e di unë. Drejtor, çka parashohin këto shpenzimet të udhëtimit në vend? Jashtë vendit po e kuptoj, veç brenda vendit, çfarë shpenzime janë këto?

**Qamil Kolloni:** Po shpenzimet e udhëtimit në vend, për arsye se kanë shkue në trajnim, në aktivitete të ndryshme, dhe të gjitha shpenzimet që bëhen brenda, ku stafi, ekzekutivi, delegatët, pjesëmarrja e tyre, transporti i tyre, shpenzimet, vikendet e të gjitha këto me radhë janë të parapame në këto shpenzime. Prandaj, në qoftë se duesh veç e veç, atëherë duhet t'i nxjerrim faturat për secilin

pozicion të flasim. Këto mbliidhen në një pozicion, shpenzime të brendshme, dhe ka pas aktivitete pak ma shumë në raport me vitin e kaluet, njëkohësisht edhe janë çmimet ma të shtrenjta se vitin e kaluet dhe i kemi të...këto kanë reflektue pak si rritje ma e madhe.

**Uran Halimi:** Unë e di që nafat paguhet, shpenzimi i transportit paguhet, në fakt është e pagume edhe e kalkulume diku tjetër. Çka shpenzime tjera, se edhe unë kam bo, për shembull, edhe ne si delegatë kemi pas udhëtime edhe seminare që kemi majt, mirpëo s'kemi bo deni shpenzim që iu faturue komunës sonë, përveç rrugës e cila llogaritet në derivate.

**Qamil Kolloni:** Mirë, qe unë po ia jap të drejtën edhe Vetimit, për secilin pozicion veç e veç që neve si total e kemi...

**Uran Halimi:** Jo, për këtë që po pyes, nëse ka dikush tjetër me pyet, po, mund m'u përgjigj, po nëse do dikush m'u përgjigj nga ekzekutivi, qe edhe ni pyetje e ka doktor Jetmiri, e masnej shënoni pyetjet edhe mundeni me u përgjigj. Faleminderit!

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje për të gjithë! Përveç rritjen e shpenzimeve që e përmendi Urani, të udhëtimit në vend, në përgjithësi te të gjitha shërbimet gati kemi rritje të shpenzimeve, t'u përfshi internetin, telefoninë mobile, shërbime kontraktuese, përveç rritja e shpenzimeve të udhëtimit në vend, vlera e karburanteve është më e ulët se vitin e kaluem, për të njëjtën periudhë të vitit. Këtë është mirë me na sqarue, ndaç drejtori i Financave, ndaç drejtori i Administratës, me na dhonë pak spjegime qysh janë hargjue paratë e qytetarëve. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, Jetmir! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën, me pyet? Në rregull, atëherë e ftoj... po, Nedžmidini e ka, shënoje ti drejtor...

**Nedžmidin Sejdlar:** Të nderuar të pranishëm, mendoj se ajo që kërkoi zoti Kryesues është me vend, sepse ju jeni këtu, përveç këtyre shpenzimeve të udhëtimit në vendin rreth 8000 euro, keni edhe shpenzime xhepi prej 442 euro zoti Drejtor. Më intereson shumë se çfarë tha zoti Kryesues për shpenzimet e udhëtimit në vend, që nëse mund ta ndani me kolona dhe të na tregoni se ku saktësisht i keni shpenzuar ato para. Sepse pak më poshtë, ju keni kosto para xhepi prej 442 euro. Pika e tretë janë kostot tuaja të internetit në shumën 1654 euro, ndryshe nga viti i kaluar që ishin vetëm 180 euro. Kjo është gati 10 herë më shumë dhe meqë jam marrë gjithë jetën me internetin, kam informacione, nuk e di që janë rritur çmimet e shërbimeve të internetit. Ku e shpenzuan atë sasi interneti? Keni edhe 990 euro shpenzime për agregate, që përafërsisht shkon në rreth 800 litra naftë, d.m.th. karburant dhe nëse e ndajmë atë mesatarisht nëse komuna ka 10 agregate, del se për këta tre muaj komuna e Dragashit ishte pa energji elektrike për mbi 70 orë. Si është e mundur, sepse unë kam folur vitin e kaluar për çështjen e agregateve, që shifrat ishin të mëdha, por askush nga ju nuk më dha përgjigje. Përveç kësaj, ne kemi karburant për automjete rreth 9530 euro dhe kemi një kilometrazh të madh. Ku i keni ecur ato kilometra dhe çfarë rezultatesh kemi marrë prej tyre? Mendoj se mjafton që të më japin përgjigje të sakta për këto pyetje. Edhe mua edhe qytetarët e kësaj komune jemi të interesuar se ku i shpenzojnë paratë e tyre.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdlar! Dikush tjetër a ka ndonjë pyetje? Atëherë e ftoj përfaqësuesin e ekzekutivit që m'u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar i Komunës, zëvendëskryesues, të nderuar asambleistë, përfaqësues të mediave! Sa i përket kategorisë së mallrave dhe shërbimeve,

pak a shumë e orientoi sqarimin e tij drejtori i Financave. Në kategorinë, në kodin 13130, pra për shpenzimet e udhëtimit në vend, përfshihen edhe të gjitha shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me pagesën e transportit për transportimin e nxënësve. Ashtu siç jeni në dijeni, Komuna e Dragashit tashmë ka marrë veprimet e nevojshme që të sigurohet transporti për të gjithë nxënësit të cilët rrugëtojnë nga një fshat në fshatin tjetër, pra paralelet e ndara të shkollave të ndryshme që veprojnë në komunën tonë. Si shembull konkret mund të marr, ta zëmë, shkollën në Brodosanë, ku nxënësit e paraleleve të ndara të shkollës së Brodosanës, të gjithave u paguhet udhëtimi. E njëjta praktikë është duke vazhduar në të gjithë fshatrat tjerë, duke përfshirë edhe regjionin e Gorës, edhe regjionin e Opojës. Për këtë arsye është kjo vlerë, të gjitha janë të dëshmuara, janë kontrata, janë vlera fikse që ne nuk mund t'i ndryshojmë dhe nuk mund t'i asgjësojmë. Për çdo paqartësi apo ndonjë kërkesë shtesë, ne jemi këtu si komunë, edhe çdo kërkesë e juaja do të pasqyrohet me argumente nga ana jonë. Sa i përket kodit 13141, shpenzime të vogla apo para xhepi, Komuna e Dragashit tashmë ka, do të thotë po i hyjmë vitit të dytë ku Komuna e Dragashit posedon vetëm një CASH, për dallim nga vitet e kaluara kur secila kategori buxhetore, respektivisht secili drejtorat ka qenë i pajisur me CASH të tij, dhe madje-madje secila shkollë ka pasur vlerën e CASH-it, që variojke nga vlera 500 euro deri në 1000 euro. Nëse më lejohet këtu me e bo një sqarim, që pikërisht për shkak të mungesës së CASH-it apo parave të gatshme të xhepit, ne jemi ballafaquar vitin e kaluar dhe këtë vit jemi duke u ballafaquar me probleme të jashtëzakonshme në të gjitha shkollat, meqenëse shkollat më herët kanë pas para xhepi dhe për gjëra të vogla, ndonjë thyerje, ta zëmë nëse një nxënës ka dëmtuar ndonjë xham, ndonjë dorezë dereje apo dritareje, ata e kanë pas tagrin dhe mundësinë që t'i paguajnë ato direkt, ndërsa tashmë është bërë jashtëzakonisht e vështirë, sepse të gjithë këto procedura duhet të zhvillohen përmes pagesave të llogarisë bankare, kur e dijme që kemi biznese të cilat nuk posedojnë këto mundësi, nuk kanë llogari bankare aktive, ne jemi ballafaquar jashtëzakonisht dhe ende po vazhdojmë të ballafaqohemi. Mirëpo, këtë vit edhe vitin e kaluar Komuna e Dragashit ka pas në total, nëse nuk gaboj, ju kërkoj ndjesë paraprakisht nëse nuk mund të jem i saktë në shifër, mirëpo nëse nuk gaboj ka qenë afër 800 euro vitin e kalura CASH-i, ndërsa këtë vit, për këtë tremujor është dhënë vlera afër 500 euro, mirëpo kjo vlerë 442 na është paralajmëruar që nuk do të shtohet aspak për tërë vitin. Do të thotë e tërë organizata buxhetore, përfshirë 8 drejtori, QKMF-në, gjimnazin, të gjitha shkollat fillore, të gjitha do të kenë në total në vlerë prej afër 500 euro CASH, që është një problem jashtëzakonisht i madh për ne. Sa i përket shpenzimeve për internet, është e saktë që kjo vlerë shënon ngritje të dukshme nga viti 2022, mirëpo arsyetimi është sepse, ashtu siç e dini, faza fillestare e vitit të ardhshëm nënkupton edhe pagesën apo lënien e faturave për t'u paguar për vitin e ardhshëm. Do të thotë, nëse në vitin 2022 kanë mbetur fatura të papaguara, të njëjtin problem e kemi me naftën, e me gjëra të ngjashme, ato në vitin e ardhshëm, do të thotë në periudhën janar – mars që do të pasqyrohet në raport, shumica prej tyre paguhet në janar apo në shkurt, kur alokohet buxheti, dhe për këtë arsye pasqyrohen domethënë të gjitha borxhet që kanë mbet nga viti i kaluar, janë paguar në këtë periudhë. Sa i përket kategorisë tjetër në lidhje me kodin 13770, sa i përket derivateve për gjenerator, vlera është jashtëzakonisht e ulët, është vlerë 990.59 euro. Keni të drejtë kur e krahasoni me reduktimet e rrymës, mirëpo duhet të keni një gjë parasysh. Një pjesë e segmentit të

largpërçuesit që kalon përmes qytezës së Dragashit, në Zlipotok dhe Restelicë, ka qenë për një kohë jashtëzakonisht të gjatë jashtë funksionit, dhe kjo ka bërë që shkolla në Restelicë, si shembull po e marr, ka qenë e detyruar që të punojë tërë kohën, që dy ndërrime të punojë me gjenerator. Nuk është vetëm ky rast, kemi edhe raste të tjera, të QKMF-së, të gjitha institucioneve të tjera, që relativisht është, jo relativisht, është qesharake vlera 990 euro për tre muaj kur të llogaritish tërë këto institucione punojnë në komunën tonë. Dhe kjo më së miri pasqyrohet nëse e krahasojmë me vitin paraprak. Sa i përket kategorisë, kodit 13780, në lidhje me karburantet për automjete, shënojmë një ulje apo rënie të shpenzimit. Në bazë të analizës sonë, del që kjo rënie e shpenzimit është si pasojë e kushteve atmosferike, dimri ka qenë më i butë këtë herë dhe si pasojë e kësaj ne kemi pas ma pak shpenzime. Besoj për këtë duhet të jemi të lumtur të gjithë, nuk duhet ta diskutojmë për të keq. Edhe sa i përket udhëtimeve apo shfrytëzimit të automjeteve komunale, për të gjitha këto, e kam bo me dije edhe në ni seancë tjetër nëse nuk gaboj, ne jemi të hapur, kemi të gjitha, secila veturë e ka bllokin e vet të vozitjes dhe për secilën prej këtyre kemi edhe kërkesa. Në qoftë se keni ndonjë vërejtje, kritikë apo edhe ndonjë dyshim që t'i shiqoni ma detajisht, jeni të mirëseardhur në zyret tona, pa aspak problem, i diskutojmë, i shiqojmë bashkë, e gjejmë realitetin si qendron. Diçka tjetër nuk besoj që pata. Ju faleminderit për vëmendjen!

**Uran Halimi:** Po, Vetim. E përmendet transportin e nxënësve të paraleleve të shkollës së Bresanës. Në rregull, thaje edhe paralelet tjera. Unë e di që në Blaç, për shembull, nxënësve që udhëtojnë nga Zaplluxhja për në Blaç nuk iu paguhet transporti, ata e bëjnë pagesën me mjete të veta, ndërsa për nxënësit e Zgatarit që udhëtojnë për në Blaç, ata udhëtojnë në këmbë. Apo kanë transport edhe ata, po, vetanak. Mos vallë është mirë që m'i përfshi edhe këto paralele, jo vetëm këto, po edhe të gjitha paralelet e komunës. Është nifare diferencimi që dikujt t'iu paguhet... dikujt duhet me iu pague e dikujt jo, mu s'po më pëlqen, s'është e drejtë kjo. Është mirë që m'i barazue, m'i trajtue barabart të gjithë nxënësit që udhëtojnë. Domethënë a e keni parapa këtë, pse s'u praktikue në të gjitha shkollat? Qet pyetje veç po due me e dijtë.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Në qoftë se kam thënë që të gjitha fshatrat, do të thotë mund të jetë lapsus lingua, mirëpo ne kemi filluar, thashë, këtë veprim, dhe jemi edhe në proces e sipër. Për shembull, rasti i gjimnazit, ne si politikë të arsimit, nëse nuk gaboj, ma herët pat diskutue edhe asambleisti Nexhat Selaj me drejtorin e atëhershëm, z.Selim Kryeziu, në lidhje me mundësinë e sigurimit të transportit, që të joshim nxënësit që të vijnë këtu. Ne ende jemi në proces, fillimisht kemi filluar me opsionin me pagesa direkte apo përmes subvencionimit të nxënësve, mirëpo një gjë e tillë, si pasojë e tërheqjes së 86 mijë eurove të të hyrave vetanake nga ana e qeverisë, ne kemi qenë të detyruar që atë strategji ta ndryshojmë, dhe tashmë jemi të detyruar që të kalojmë përmes procedurave të tenderimit, gjë e cila është jashtëzakonisht ma e vështirë edhe, dorën në zemrë, është ma e dëmshme edhe për operatorët ekonomikë vendorë, sepse në momentin që hyjnë në tender për disa linja, aty nuk mund ta shikosh kush do ta marrë. Ndërsa e kemi përgatitur specifikacionin, javën tjetër besoj që rregullohet hapja. Dhe, sa u përket shkollave, më lejoni të them që aspak nuk do të ketë diferencim, të gjithë banorët e Komunës së Dragashit, në rregull, jemi në proces e sipër, nuk besoj që do të ndikojë shumë në qoftë se ni muaj, dy muaj më herët apo më vonë do ta rregullojmë një gjë të tillë. Ne kemi pranuar kërkesa nga të gjitha fshatrat të

cilët udhëtojnë, veçanërisht ka fshatra të cilët i ekspozohen edhe rrezikut gjatë transportit. Për shembull, rasti i nxënësve që vijnë nga fshati Zgatar në drejtim të fshatit Blaç, apo nga fshati Plavë në drejtim të Llopushnikut. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Fjalën e ka kërkuar z.Qamil Kolloni, më duket e ka gjet defektin. Po, mundish me dalë me e sqarue. Në rregull.

**Qamil Kolloni:** Faleminderit, kryesues! Shpetim, për fat të mirë na e nxorëm qeto prej sistemit edhe uebfaqes. Neve nuk po na paraqiten qeto dukuri, ndoshta kemi bo gabim, unë prapë po them, nuk po insistoj në atë. Qet raportin që ma pru ZKF, prej të dhënave të sistemit të viti të kaluar edhe krahasimin me këtë vit, kemi 81,715.86, 81,715.86 që janë edhe në raportin e vitit të kaluar. Në qoftë se dësh, unë nuk po të kundërshtoj, po due me të thonë që në sistem si të dhëna zyrtare janë qeto dy të dhënat, dhe qeto janë vendimtare dhe përfundimtare që përputhen njëra me tjetrën. Unë nuk jam t' o dijt edhe çfarë raporti kie, po unë nuk po të kundërshtoj dhe nuk po të...po besoj edhe atë ti që po e thuesh, mirëpo qeto të dhëna na i kemi realisht qetu. Po, po, në rregull, në rregull, pra e kie 125,263 për vitin 2021, që përputhet me 125,263 gjithashtu për vitin 2021 të raportit të sivjetshëm. Unë nuk po due me hy në polemika, nuk është çështje që kjo ndikon në raport, po për hir të korrektësisë, për arsye se qeto të dhëna janë zyrtare dhe qeto nxirren prej ZKF, prej sistemit, të cilat janë të verifikume dhe janë të dhëna përfundimtare.

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Fjalën e ka z.Shpetim Hajredini. Më fal, deshta me pyet a është raport i cili na është servue neve si asambleistë, apo i vitit të kalum. Drejtor, a t'ia sqaroj unë, më fal. Okej.

**Shpetim Hajredini:** Jo jo, qe unë ia sqaroj. Atëherë, thashë, nëse ka ndodhë diçka dhe në raportin e kaluar, materialin e kaluar, kur na kanë dërgue neve, ka ndodhë gabimi dhe pastaj është përmirësue, dhe tash aty e kanë në rregull...ky raport mu më ka ardhë prej Zyrës së Kuvendit. Këtë e kam këtu, ky është 2022-shi...

**Uran Halimi:** Më fal, këtë raport, ti Shpetim, e ke pranue në material të seancës kur u knoë raporti i vitit 2022? A po kuptojsh, drejtor?

**Shpetim Hajredini:** Se unë i kam të gjitha nëpër fasiklla. Çdo seancë që e kam, e majm, me të gjitha materialet e kam. Këtë e kam nxjerrë prej 2022-shit, të vitit kaluar, ky është 2023, i këtij viti. Bëjsh krahasimet e vitit 2022 me krahasimet e të dhënave këtë vit, po të njëjtin viti 2022-shi, nuk përputhen. Janë të ndryshume. Qetaj çka ka ndodhë, unë për atë e bëra pyetjen, që ta kam sqarimin. Unë lexoj edhe e thom atë çka e shoh.

**Uran Halimi:** Unë mendova që u gjet defekti, po prapë s'konga gjet...

**Shpetim Hajredini:** Tash është problem që nuk po e di çka ka ndodhë...

**Uran Halimi:** Qetash, cili është i besueshëm kemi ra në dilemë, po duhet m'u kthye në vitin 2022. Raporti po besoj që është i besueshëm ai i cili është dërgue nga Drejtoria juaj te Zyra e Kuvendit për me iu shpërnda kuvendarëve. Qeky duhet m'u knoë ma i besueshëm. Nëse qeky s' o i besueshëm, s' kemi çka folim...

**Shpetim Hajredini:** Shiko, jo, esenca është e asaj që, pothuajse në të gjitha tabelat në të cilat bojsh krahasime, po të njëjtin vit 2022-shi, i njëjti vit, vetëm dallimi qendron ndërmjet raportit të vitit të kaluem dhe raportit të këtij viti. A i njëjti vit është, të njëjtat shpenzime, nuk guxojsh m'i ndryshue.

TM1-shin – unë ekonomist jam, i kuptoj – TM2, TM3, s'kie shancë ti me e ndryshue as 0.01. Ai është përfundimtari. 20 euro, 20 euro i ke të evidentume tremujorin e parë TM1-shin, në vitin 2034, nëse don ti me e nxjerrë, ka me të dalë 20 euro o burrë, nuk guxon me ndryshue kjo. S'kemi të bëjmë na këtu me matematikë të thjeshtë, 1+1 bojnë 2 edhe u krye, s'ka mo aty, s'ndryshon. Unë nuk e di çka ka ndodhë me këta, edhe çka ka ndodhë ndërmjet ministrisë, do të thotë kur e kanë bo këta raportimin vitin e kaluar. Në këtë raportim mu po më figurojnë të gjitha të ndryshume edhe nuk përputhen njëra me tjetrën. Tjetra, në raportin final, munden me shikue edhe drejtori i Financave, edhe raportin final kur e kemi pas të vitit 2022, po të njëjtën shkelje e ka pas, 2021-shi janë të dhënat e 2018-shit të bartshme. Unë nuk kam qenë në atë seancë pjesëmarrës edhe s'kam mujt, do të thotë, me e tregue këtë gabim, këtë lëshim. Le ta merr, le ta boje krahasimin me 2018, shpenzimet, me 2021-shin, nëse nuk i ka të barturat të njëjta, ose si të doje i marr unë edhe ja bie. Unë të thashë, nuk po muj me thonë që e ka bo pa dije, bëhen këto lëshime, mirëpo nuk mujsh me më qit gabim sa i përket këtyre gjërave, se këto nuk guxojnë me u ndryshue. Nuk ka lëshime 1+1 bëjnë 2, edhe ajo nuk ndërron mo kurrë. TM1-shi 20 mijë, 20 mijë shpenzim, paga, çkado që të jetë, nuk guxon me ndryshue në vitin 2023, i njëjti vit. Ky është lëshim, është gabim, duhet me e pranue këtë. Pastaj, ministria çka ka bo, aty unë nuk e di. Është dashtë me na pru atëherë ni raport tjetër edhe aspak nuk do ta kisha marrë fjalën, as nuk do të kisha bo krahasime, atëherë nuk kisha diskutue fare. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Hajredini! Edhe ni minutë Nedžmidini po e kërkon fjalën edhe po e përmbyllim këtë. Ju lutem, le ta mbarojë fjalën z.Sejdilar. Mund të fillosh.

**Nedžmidin Sejdilar:** I nderuar drejtor, herën e fundit kur raportuat për shpenzimet e vitit 2022, ju këtu nga kjo foltore më akuzuat për manipulim të publikut, kur ju thashë se keni shpenzuar një sasi anormale karburanti për transport dhe më pas si justifikim thatë se karburanti përfshinte transportin e studentëve. Tani këtu ju na thoni që kostot e udhëtimit brenda vendit përfshijnë kostot e transportit të studentëve. Unë me të vërtetë nuk e di se çfarë të besoj. Sa i përket linjës së famshme të transmisionit që çon në Restelicë, ajo nuk ka funksionuar për tre ditë në 2022, nga 21 dhjetori deri më 24 dhjetor, kështu që nuk e di pse i keni ndezur gjeneratorët në 2023 nëse nuk ka pasur nevojë.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.! Ni minutë replikë e ka Vetimi edhe e përmbyllim mo këtë çështje.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Sa i përket çështjes që e ngriti asambleisti z.Sejdilar, është shumë e vërtetë atë që e kam thënë edhe janë gjëra të cilat nuk varen prej meje edhe nuk munda m'i ndryshue. Transporti i nxënësve mundësohet me autobus komunal. Transporti, a keni njohuri ju që ka nxënësia të komunitetit që vijnë në mësim çdo ditë në Dragash? I kemi diskutue non-stop këto punë. Edhe sa i përket largpërçuesit, largpërçuesi nuk ka qenë tre ditë. Tre ditë mund t'ju është dukur juve që keni qenë në Dragash, mu, unë nuk kam pas asnjë ditë reduktim. Mirëpo shkolla e Restelicës, i kemi kërkesat, kurdo që ju dëshironi mundeni me ardhë, kemi kërkesat që i ka drejtuar drejtori i shkollës fillore në Restelicë. Ai ka sjellur kërkesa dhe arsyeshmëria ka qenë që ne jemi të detyruar, meqenëse nuk kemi rrymë elektrike. E njëjta ka ndodhur edhe me ngritjen e shpenzimeve, sepse është me ni kategori, shpenzimet për gjenerator, kanë qenë tek AMF në Restelicë dhe në komplet atë pjesën që e ka afektue largpërçuesi. Të jeni të sigurt që nuk ka qenë

tre ditë edhe mundemi ni ditë, kurdo që ju dëshironi, shkojmë bashkë dhe e marrim vesh këtë punë edhe në KEDS, sepse KEDS-i i ka të gjitha statistikat. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit shumë! Me sa kuptova unë, te ai transporti i nxënësve që s'mundin këta me e pas një kod të veçantë - u krye Jetmir mo për këtë pikë – i bjer që hargjimet dhe shpenzimet e naftës këta ose i rritin shpenzimet në vend, do i shpërndajnë te agregati edhe do tjera te nafta, edhe i bojnë do punë. Mirë, sidoqoftë, është punë e mirë, mos të ecin nxënësat në këmbë. Po vazhdojmë me...p'e qesim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Te pika e dytë, është fjala për raportin e realizimit të buxhetit. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? I kemi 14 vota pro. Kush është kundër këtij raporti? Edhe abstenim? Domethën me 14 vota pro, me 1 kundër...kush ke abstenim? Atëherë konstatoj që me 14 vota pro, me 1 kundër edhe me 11 abstenime, kalon pika e dytë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e tretë, është Propozim-vendimi për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Dragashit. Nëse e mbani në mend, kjo është pikë që e kemi trajtue në seancën e kalume. Le të na kallxojë dikush prej ekzekutivit pse na erdh prapë. Prej ekzekutivit po them. A kie me pyet a? Në rregull, ni pyetje prej meje e keni, pse prapë p'e trajtojmë këtë çështje, edhe fjalën e ka kërkuar z.Nexhat Selaj, pas tij fjalën e ka z.Driton Ademi. Edhe vazhdojmë me radhë, prej ekzekutivit mblidhni pyetjet edhe njo kush del i përgjigjet krejtave.

**Nexhat Selaj:** Përsëritet për të gjithë, përsëritet kryetar, kolegë asambleistë! Deshta të ndërlihem pak tek propozimi i vendimit për emërimin e Komisionit. Ma shkurt do t'i drejtohem drejtorit të Administratës, pasi që seancën e kaluar – thuhet ni fjalë popullore se mosdija s'ka derë, unë nuk pranoj, po mosdija ka derë nëse pyesim, derën e gjojmë. Ne ju treguam, drejtor, kur u bo përzgjedhja si të komisioni i prindërve, tek Ajas Myrtezani, thatë se ka të drejtë, shumë mirë ju tregova në aspektin ligjor se nuk ka të drejtë të zgjidhet përderisa nuk është kryetar i prindërve në atë shkollë. Thatë është arkatar dhe ka të drejtë. U tërhoq, apo e tërhoqët, apo e larguan nga niveli qendror, këtu do të na japësh një sqarim, çka ndodhi me atë. Të dytin e kemi nga DKA-ja, anëtarin tjetër, Faton Nafezi. Jam i sigurt se edhe ky do të kthehet mbrap, pasi që me rregullore, me ligj, çfarëdo i punësuar qoftë, që të ketë një kontakt pune, në vitin e parë ai është si fillestar dhe nuk ka përvojë pune dhe nuk mund të merret në asnjë aktivitet zgjedhor, përderisa nuk përfundon një vit. Unë jam shumë i sigurt, ju nëse keni siguri dhe ligj, mund të më japësh përgjigje. Jam i sigurt te kjo dhe këtë po ju them: mos të gabojmë disa herë. Gabuam ni herë me rastin e parë, tek përzgjedhja e Ajas Myrtezanit, që me këmbëngulësi tregove se ka të drejtë, e çka ndodhi tash, tash edhe ni herë po duhet ne me votue. Mos të dalim qesharak, nëse dëshironi veç t'i plotësoni dëshirën anëtarëve të juaj, tani me thonë s'po na lonë, mos maltretoni. Ne jemi këtu për bashkëqeverisje, jemi këtu që t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, mos të dalim keq edhe para mediave, edhe para qytetarëve, po mos të dalim keq edhe para nivelit qendror. Se sikur po paraqitemi që nuk dijmë. Ne po dijmë, po ashtu po dojmë. Kështu që kishte me qenë mirë, kryetari nuk është këtu, në fillim është zotue se do të kemi bashkëqeverisje me të vërtetë të mirëfilltë. Nëse është qekjo bashkëqeverisje e mirëfilltë, unë nuk di çfarë ka tjetër. Kështu që i ke dy pyetje. Të parën, largimin e Ajas Myrtezanit, dhe të dytën, unë po ju siguroj se nuk ka të drejtë ligjore që anëtari nga DKA-ja të përfaqësohet, pasi që nuk ka ni vjet përvojë pune, ai është si fillestar. Kaq. Praktikant. Me ligj, viti i parë është

si praktikant, pas asaj, si mundohet që, më falni, si mund të është praktikanti të bëjë përzgjedhjen e drejtorit, kur akoma ai është vetë praktikant? Unë e kuptoj se ai është muaji i pestë apo i gjashtë dhe pa dyshim, atë e di qindpërqind, se kontrata e tij do t'i vazhdojë, atë jam shumë i sigurt, po në këtë periudhë ai është si praktikant. Periudha është praktikante. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Si të kemi pyetje tjera po...Dritoni e ka kërkuar fjalën, po...

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Unë deshta m'u ndërlidhë te emri i dytë, Fatmir Mehmeti, ekspert i pavarur i arsimit. Në UA, te pika 3.1 thotë dy anëtarë të Komunës. Lind pyetja, Fatmir Mehmeti a është anëtar i Komunës? Me sa e di unë, me ligj, anëtarët e Komunës janë, mos t'i quaj domethënë, prej pastruesit e deri te kryetari, qoftë infermier, mësues ose diçka. Ky anëtar i Komunës nuk është. Ky munden m'u konë ekspert, nuk jam kundër këtij si person. E dyta, drejtor i institucionit arsimor në performancë, nuk është anëtar i Komunës me asnjë drejtor i institucionit arsimor, në Komunën tonë po flas prapë. Edhe përfaqësues nga këshilli i prindërve, domethënë ceken këto tri pyetjet këtu, tri kriteret që munden me i pas, që duhet m'i pas ky eksperti i pavarur i arsimit. Po, po në fillim te 3.1 thuhet duhet dy anëtarë të Komunës. A është anëtar i Komunës Fatmir Mehmeti? Me sa unë e kuptoj dhe me sa unë e di, anëtar i Komunës quhet që m'u konë në nivel institucional, jo banor i Komunës. As nuk përfaqëson asnjë nivel institucional në nivel të komunës ky. Munden me përfaqësue në Prizren, po në nivel qetu në komunën tonë jo. Edhe te pyetja e dytë që ata ditë me Vetimin e kemi sqarue. Vetim, përzgjedhja e Komisionit po bëhet sot, më 27. A je në dijeni që ky Komision ka afat deri më 31.08.2023? Dhe nuk ka afat, Komisioni përzgjedhës domethënë fillon me vit shkollor, nëse ka fillue viti shkollor 01.09.2022, mbaron më 31.08.2023. Ky Komision, sot ose kurdo që të formohet, e ka mandatin deri më 31 gusht, nuk ka mandate ma shumë se ni vit. Domethënë, mas 31 gushtit nëse ju nuk i përzgjedhni qeta drejtorat, qysh jinni t'o i bo në shkollë të Bresanës e shumë sende, atëherë nëse nuk i zgjidhni, çka kini me bo? Në shtator ke me na pru prapë me krijue anëtarë tjerë a? Domethënë jeni në dijeni që deri në shtator e ka afatin ky Komision? Okej, ni sqarim për te Fatmir Mehmeti kisha pas qef me e dijt, që dy anëtarë të Komunës, a është anëtar i Komunës a jo. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ademi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Ju lutem, kërkonti fjalën përpara se me e dhënë sqarimin drejtori, se pastaj s'keni mo fjalë, keni vetëm replika nëse atakohet dikush personalisht. Okej, hajde drejtor.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Meqenëse asambleisti nga radhët e PDK-së, z.Nexhat Selaj, e nisi me një shprehje popullore, më lejoni ta them edhe unë një shprehje popullore: Nuk është problem kurrë cilësia e respektit që ua japish njerëzve, është problem cilësia e njerëzve që e marrin respektin. Unë prof vazhdimisht të kam respektue, vazhdimisht më je drejtue me një gjuhë ofenduese. Nuk është që nuk dimë edhe na me e përdorë atë fjalor, po këtu, së paku unë prej institucionit ku ti ligjërosh, kam dalë edhe e kam marrë një edukatë që nuk duhet me ofendue mbi baza të ndryshme. Edhe unë, personalisht, nëse flasim në rrafshin personal, nuk është që ia maroj vetit qefin. Unë jam i thirrur për atë çka jam i diplomuet, edhe aty njohuritë e mia janë relative, sepse absolut është veç Allahu. Mirëpo e kam një të mirë që pyes edhe mësoj, për dallim nga disadisa. E, sa i përket arsyes, kërkove pse është tërhek. Personi në fjalë, edhe pse nuk është ndoshta e hijshme që ta lakojmë këtu, se këtë punë kisha mujt me ta tregue edhe në bisedë joformale, nëse



kishe pas interesin e vërtetë ta dish për çfarë arsye, por personi i cili ka qenë i propozuar ka obligime familjare, ka ni rast familjar ma specifik, nuk është për shkak të konsekuencave penale apo diçka të ngjashme, po këtë munda në bisedë joformale me ta tregue. Po thjesht është për çështje familjare. Ndërsa, sa i përket UA që tha Dritoni, unë ekspert ligjor nuk jam, por anëtari i Komunës ka mundur të jetë, s'precizohet Udhëzimi, në judikaturë është ni gjo, ni thënie e bukur, thotë 'çdo gjo e cila nuk ndalohet është e lejuar'. Në qoftë se nuk ndalohet në mënyrë të precizuar, unë gjykatës nuk jam, as avokat, mirëpo di kaq, sa që besoj që jemi brenda kornizave. Personi në fjalë është person i cili në certifikatë të vendbanimit të tij e ka Komunën tonë, është profesor i respektuar, jeton edhe këtu, ka shtëpi, ka trollin e vet, ka shtëpi, ka prona të trashëguara nga prindërit e tij, po ne tash nuk mund të bëjmë gjyqin ni anëtari të thjeshtë. Për sa i përket kësaj, edhe sa i përket afatit që e theksove, afatin na jemi të vetëdijshëm, e kemi diskutue edhe në seancën e kaluar, do të thotë është një vit shkollor, viti shkollor përfundon më 30-31 gusht, varësisht nga gjatësia e muajit, dhe në rast se procedurat vazhdojnë edhe më tej, ne normal, drejtori i Arsimit është i detyruar që të kërkojë nga Asambleja të zgjat mandatin apo të propozojë Komision të ri. Kjo gjë nuk varet nga ne, janë gjëra të precizime me Udhëzim. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Përhëndetje edhe ni herë! Drejtor, nëse ke durim. E përdore ni term pak si ofendues. Nuk e di çfarë të kundërshtova, edhe nuk e di çfarë fola me ni pretendim si, sa politikë sa e more. Derisa këtu në Kuvend ke deklarue se ka të drejtë të ushtrojë detyrën, unë kërkova sqarime për personin, pse nuk është tash, pse u zëvendësue, derisa në Kuvend jepet raporti për po, në Kuvend po besoj se duhet të jepet raporti edhe pse jo. Unë nuk kuptova diçka tjetër, përderisa po mundohesh ta mbulosh atë të cilën të kam këshillue, po më vjen mirë, ashtu si të kam këshillue në shkollë, që ke dalë sot inxhinier, po më vjen mirë, kam kënaqësi, po të këshilloj edhe këtu mos të gabosh. Në këtë foltore ke thënë se është arkëtar në shkollën 'Ilmi Bahtijari'. Arkëtar nuk ka këshilli i prindërve. Ti duhesh ta dish atë, po dëgjo, nëse nuk dëgjosh kie me gabue gjithasherë. Edhe të kam tregue se si shkon mënyra e përzgjedhjes, nuk e ke pranue, e keni propozue, i ke votat, unë po t'i kundërshtoj votat, pop o të diktoj që mos të gabosh në të ardhmen. Kjo ishte, unë nuk pashë diçka provokim. Te e dyta, se nuk jemi të thirrur për provokim, jemi të thirrur për ndihmesë, edhe kur të keni dëshirë për ndihmesë, për të mirë, ja ku më ke. E dyta, të kërkova për anëtarin e dytë, i cili vjen nga DKA-ja. Tash po të tregoj, shkruje, maje në mend, nuk dhaje përgjigje. Përderisa është viti i parë, edhe nëse është me kontratë të përhershme, ai llogaritet si praktikant, është muaji i pestë apo i gjashtë i cili e zhvillon detyrën, fare nuk kam absolutikisht kundra diçka, na kthehet mbrap, pasi që nuk mund të është ai vendimmarrës në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollës. Në asnjë mënyrë nuk kam të keqe këtu, unë nuk e di çfarë ju po shihni të keqe, kur po të mësoj diçka se si duhet të mos gabojmë. Këto po na kthehen mbrapa, bonu i sinqertë, kandidati i parë është kthye nga ministria, na është kthye mbrap, të jesh i sinqertë. Kaq.

**Driton Ademi:** Vetim, edhe ni herë po të thom, është mirë me pyet, dy anëtarë të Komunës në mënyrë ligjore, e kam çështjen veç për mos me na kthye prapë, se na po dalim keq si komunë. Edhe ni pyetje e tretë, te pika 3.3 e UA, të cilët janë dy vëzhgues, a duhet të dihen emrat e atyre vëzhguesve, domethënë ku përfaqësohen ata, a shkojnë në nivel të komunës përfaqësuesit, ni anëtar i këshillit të prindërve edhe një i shkollës, apo caktohen nëpër shkolla. Domethënë, unë me

sa e di është në procedurë shkolla e Bresanës edhe e Blaçit, a keni m'i caktue të shkollës së Bresanës ose të Blaçit, apo në nivel të komunës keni m'i caktue. Faleminderit!

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, zëvendëskryesues! Atëherë meqenëse ishte i fundit Dritoni. Driton, sa i përket anëtarëve vëzhgues, anëtari vëzhgues është anëtar vëzhgues, nuk ka rëndësi, ne atje nuk do ta vendosim fatin e komunës, aty do të shiqohen kriteret, ka afate të ankesave në qoftë se ni kandidat i cili pretendon se i është bërë shkelje ose nuk ka qenë vlerësimi i duhur për kualifikimet e tij, janë institucionet që parashihen. Mund të shkojnë deri në panelin në kuadër të Ministrisë së Arsimit. Kush mund ta pengojë të drejtën e realizimit të dyshimeve të tij. Fillimisht fillon prej Komisionit Komunal, duke vazhduar deri në panelin e Ministrisë së Arsimit. Sa i përket anëtarëve nuk ka aspak problem. Do të ishte e rrugës, që unë besoj se është ni zotim në parim që, meqenëse edhe shumicën prej konkurseve që zhvillohen në kuadër të DKA-së, gjithmonë një anëtar i Komisionit është nga shkolla. Meqenëse e njuh problematikën e shkollës, e njuh situatën atje edhe është e rrugës që të jetë një nga shkolla. Kështu që besoj që kjo praktikë do të ndiqet edhe me Komisionin. Për pozita të cilat janë në shkolla të veçanta, e mira është që do të jenë dy vëzhgues, mund ta zëmë veç në qoftë se janë 3-4 konkurse në të njëjtën kohë në proces, dy prej shkollave të cilat janë në proces të jenë vëzhgues, aspak nuk ka të keqe në këtë drejtim. Ata nuk kanë të drejtë të përzihen, ata shënojnë dhe vërejtjet e tyre mund t'i dërgojnë në instanca tjera ma të larta, dhe për këtë ekzistojnë institucione tashmë. Sa i përket profesorit, prof veç diçka po të thom, se nuk po kam qef ma shumë me replikue për këtë temë, në qoftë se ka kthim nga ministria për këtë punë, unë qysh nesër jap dorëheqje. Po ta zotoj kështu burrisht. Faleminderit! A ma bojsh hallal veç edhe pak, se dy herë e harrova. Edhe për pikën e anëtarit të parë, anëtari i parë nuk ka të drejtë të jetë pjesë e Komisionit, unë do të isha mirënjohës nëse do të ma sillje atë ligj ku e precizon që për një vit na qenka një zyrtar që punon në shërbimin civil të Komunës së Dragashit, është në fazë të praktikantit. Faza nuk është praktikant as gjashtë muaj. Gjashtë muaj është afati kur ai supozohet që të jetë i mësuar me punën e tij, dhe si pasojë nuk rekomandohet prania e tij në komisione, qoftë komisione të pranimit, si inxhinier, qoftë në komisione të tjera. Pas atij afati, në të gjitha këto... unë do t'ju isha mirënjohës të ma sillni. Shumë në rregull, ju kisha lut me ma sjellë, zyrën ma dini, ose më thirr, unë vij te ti. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Sa i përket detyrave të Komisionit, ti i kie te neni 2 të shkruame, te neni 2 i vendimit, ia huqe pak dejtor, po s'ka lidhje, jot i fole për Komisionin, edhe te neni 2 shkrun që detyrë e këtj Komisioni përzgjedhës është që të bëjë intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të cilët kanë konkuruar me konkursin për pozitën e drejtorit apo zëvendësdrejtorit, dhe në bazë të pikëve të fituara bën ranglistën e kandidatëve, dhe kandidatin më të suksesshëm ia rekomandon kryetarit të komunës për emërim në pozitën e drejtorit apo zëvendësdrejtorit të shkollës sipas konkursit. Tjetra, sa i përket asaj që ia kërkove z.Selaj, unë jam i të njëjtit mendim, edhe kie me hup edhe te kjo, mirëpo kur ta bjer z.Selaj atë dëshminë, është mirë me e pru publikisht këtu në seancë edhe me e pa edhe na, se aty në zyrë s'kërkosh falje, unë këtu të kishom shti me kërkue falje. Edhe po ia japim fjalën z.Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Përsëndetje edhe ni herë! Drejtor, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, është hera e dytë që po diskutjmë, herën e parë i ke pru emran që s't'i kanë plotësue kushtet, ke thirrë

edhe ni herë, e ke shti si pikë të rendit të ditës për herë të dytë, prapë po shihet që qata anëtarë që i ke propozue s'kanë me t'i plotësue kushtet. A është patjetër që anëtarët e këtij Komisioni m'u konë anëtarë të LDK-së, apo në krejt komunën tonë nuk kemi na njerëz tjerë për me e formue këtë Komision, a nuk kemi profesionista për me formue ni Komision për me bo përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Është absurde, mos na e bjer edhe ni herë si pikë të rendit të ditës formimin e këtij Komisioni, përzgjedhi tre emra që t'i plotësojnë kushtet edhe bjere ta votojmë krejt së bashku, krejt jemi për me pas drejtorë të suksesshëm të shkollave edhe me vazhdue procesi!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ajdini! Edhe ni minutë e lypj Dritoni, se s'po kam mundësi me ia mohue të drejtën e fjalës.

**Driton Ademi:** E kam ni pyetje për drejtorin. Vendimet të cilat i kthen ministria, a kemi të drejtë na si Asamble me i pa? Pse nuk po na biesh pra me i pa? Unë sot po kërkoj që vendimet të cilat na i kthen ministria, në seancat e ardhshme neve me na pru në material. Atëherë, po mirë, kryesuesit e pyeta, po unë po i thom edhe drejtorit, vendimet kuj i shkojnë? A kush i fshehon, qata, a kryesuesi a kryetari a drejtori atyna, Ani po të pyes, të kam pyet edhe disa herë, qetash unë po të thom vendimet a ka mundësi të cilat na i kthen ministria me na pru në material, edhe me e ditë a u kthye emri i Uranit, a u kthye emri i Dritonit.

**Uran Halimi:** Të kuptova, faleminderit! Jo, unë duhet me ia dhonë përgjigjen, qetash vendimet, sa i përket pyetjes së Dritonit, ty po të përgjigjem, sa i përket pyetjes që ti e bone, Driton, m'u dashtë me iu ardhë anëtarëve të Kuvendit ai vendimi, jau bojnë CC edhe juve, ata vetë duhet me jau dërgue direkt, m'u konë pa qare ju me i pas, mirëpo kur ta doni deni vendim me e pa, ju mos hezitoni. Po s'është vendim që u kthye, ky ma së pari, formimi i Komisionit të parë nuk ka shkuë, se ai erifi ka dhonë dorëheqje, numri dy ka dhënë dorëheqje para se me shkue vendimi. Prit, mandej. Pjesa tjetër, mu po më pëlqen drejtori që po insiston, po s'po më pëlqen se s'ka marre mo me ardhë edhe ni herë për të njëjtën pikë, kur na po i thona s'bon qekjo, po vjen edhe ni herë. Unë kam qef me e pa drejtorin kur të kthehet prapë. Kur të kthehet prapë qeky vendimi, kom me jau printue edhe kom me jau shpërnda, ose të paktën kom me jau dërgue në email. Hajde drejtor. Ni pyetje le ta bon, hajde.

**Artan Loshaj:** Zotni drejtor, ndoshta e marrish si provokim, po deshta me ta bo ni pyetje. Sot po më dokesh shumë aktiv, a je t'u bo gati për zgjedhje apo këta drejtorat, në emër të gjithve që po folish, s'i kie shumë në disponim, apo janë shumë, marre me thonë, të paafte për me dhonë përgjigje. Na e bëmë pares ma herët ni pyetje për drejtorin e Financave, i more kompetencat dole këtu, tash për drejtorin e Arsimit, nuk po e akuzoj sot, se është drejtor i ri, i more këto... domethënë po e bësh gati, kryetar, për zgjedhjet tjera apo? Jo, mu m'u dok se drejtorat sot s'i kie në disponim edhe nënkryetarin s'ke desht me ngarkue. Herat tjera, unë kam qef si asambleist, se i di do rregulla, që kur të bëjmë pyetje ni drejtori përkatëse, o del drejtori, o del kryetari o nënkryetari. Për drejtorinë tënde boll kie me folë, po mirë shumë aktiv sot, si Messi.

**Uran Halimi:** Faleminderit, Artan! Ta ngojmë edhe ni minutë. Ni minutë, Vetim.

**Vetim Ramadani:** Më lejoni një gjë, edhe për herë të fundit po e them. Nëse, ia dhashë një bast profës, po duhet me ndryshue, publikisht p'e jap bastin. Driton Ademi po himë na të dy publikisht. Unë jap dorëheqje nga posti i drejtorit të Administratës në qoftë se vendimi në fjalë është kthye

ni herë të vetme – kadal, kadal – po edhe ti duhet me dhonë dorëheqje, këtu vëne ni bast, nëse nuk ke qenë i punësum në Komunë, e krejt njerëzve ju ke thonë që nuk je. Po edhe personale si të dësh merre, merre personale si të dësh.

**Uran Halimi:** Çështja është kështu, unë mendova që po vë bast Vetimi që nëse kthehet vendimi, ti thaje që s’u kthye, atë unë e dëshmovava që s’u kthye. Sidoqoftë, e përmbyllim këtë diskutim. Ju lutem, majeni qetësinë, personalet boni personalisht atje diku jashtë, këtu jemi t’o bo të përgjithshmën edhe atë që i përket qytetarëve. Na mundohna me bo pyetje për shkak të llogaridhënies që e kemi në raport me qytetarin, sa për atë personale, bojmë pyetje atje në rrugë, ju lutem, nap o bëjmë pyetje për me i sqarue opinionit publik, atyre njerëzve që ju kemi kërkue votën, cila është e duhura, cila është transparentja, cila është e ligjit. Është e turpshme me na pa qytetarët t’u i zgjidhë personale. Personale është diçka personale, mos e qitni publike personalen, ju lutem. Po vazhdojmë, e kryem mo këtë pikë të rendit të ditës, e qesim në votim pikën e tretë, Propozim-Vendimin për Emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Abstenim? I Kemi 14 vota pro, 11 kundër edhe zero abstenim. Kalon Komisioni, me shpresë që s’ka m’u kthye mo.

E kemi vazhdim të seancës Propozim-vendimin për korrigjimin në Regjistrin kadastral. Qetash hupi pak disponimi, se unë ju thashë edhe ma herët me bo pyetje rreth pikave që i kemi për diskutim. Ju lus mos me devijue mo jashtë pikave, edhe mos me e keqpërdorë atë tolerancën që unë jau jap vazhdimisht. S’kam qef m’u konë strikt, se s’është strikte edhe absolute kurgjo në këtë botë. Po vazhdojmë për Propozim-vendimin për korrigjimin në Regjistrin kadastral. Kush do me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Pyetje, kush ka pyetje drejtuar ekzekutivit në lidhje me këtë pikë, ju lutem, e kemi kohën për pyetje. Mundohnu ju asambleistët me e shfrytëzue kohën, keni dhjetë minuta kohë, boni pyetje, pyetje, pyetje. Kurt ë vjen koha për me dhënë përgjigje, ka vetëm replikë ni minutë mandej, është ni replikë, eventualisht e dyta kur është shumë e rëndësishme. Pyetje jo, shtatë replika. Vazhdimisht, ma shumë humbni kohë me replika, se sa në kohën e shfrytëzimit kur i keni dhjetë minuta. Ju ftoj të nderuar delegatë, nëse ndonjëri prej juve ka pyetje? Nëse jo, atëherë veç e ftojmë një nga ekzekutivi që me... kryetari atëherë e ka shprehë dëshirën, a po kryetar? E ftojmë kryetarin me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë.

**Bexhet Xheladini:** Atëherë edhe një herë ju përshëndes! Megjithatë, është klima e mirë, nuk është e keqe, edhe debatet pro et contra janë të shëndosha edhe të mirëseardhura, edhe unë i përshëndes ato, pavarësisht janë për ose kundër. Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ne në Kadastral kemi hulumtue se ni pronë të cilën e kemi dhonë aty si pikë, ekziston ende e padefinime, si pronë e paregjistrume në emër të askujt. Kemi kërkuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës me na dhënë sqarime për këtë pronën, pse. Kamp yet ni zyrtar të AKP-së çka është puna me këtë pronë, ata kanë thënë nuk është pronë e jona, dhe masi kërkush nuk po deklarohet për këtë pronë, kjo pronë është në tokën tonë, në komunën tonë, në territorin e Opojës, dhe është e jona dhe ne si Kuvend duhet të marrim ni qëndrim, siç e keni marrë ju ni qëndrim shumë të mirë, ndoshta keni dëgjuem, e kam përshëndet edhe vendimin e juaj që e keni marrë kur i keni kthye tokat, është edhe në KTV e kam dhënë atë deklaratë, edhe sot duhet ta merrni ni qëndrim, këto toka t’i regjistrojmë në pronësi të

Kuvendit Komunal në Dragash. Qekaq. Ma shumë nëse do dikush pyetje, ma shumë s' di edhe me sqarue, unë qato që i dita i thashë.

**Uran Halimi:** Po më pëlqen si ide. Sidoqoftë, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Po s'ka me diskutue, replikë, fjalë s'kërkoj kush. Po ju ftoj, nëse keni diçka me shtue. Artani.

**Artan Loshaj:** Kryetar, e di përgjigjen, se vetë thajë që nuk di ma tepër, po deshta veç ni pyetje. Kush i ka shfrytëzuar deri më tash këto parcela? Edhe a kishte qenë mirë me pas edhe hartën – se unë jam punëtor shëndetësor edhe s'punoj në Urbanizëm – kjo është veç fleta poseduese, a kishte qenë mirë me pas edhe ni hartë, qat zonën, a po prekim dikond aty. Domethënë veç me ni dokument p'i marrim në emër të Komunës, është mirë, se kryetari edhe kryesuesi i partisë tonë kanë qenë nëpër gjykata për këto lëndë, ju e dini shumë mirë, edhe vetë thajë që mirë kanë bo që i kanë kthye, po ju po thoni qysh është e mundshme deri tash kjo me qenë e pashfrytëzuar edhe kush e vërejt këtu sot, pse s'e keni vërejt që dy vite. Mirë, e imja është me pyet, se sa herë po foli unë s'po ju ndërpres, se masnej po më nxitni, edhe kishte qenë mirë me pas edhe ni hartë, ma konkretisht m'u bo, se nuk është kjo ni pjesë e vogël, po është ni pjesë bajagi e madhe, mos po na del problem najherë me këta qytetarët, dekush shkon e vë naj... thotë qetu është midisi i dynjasë edhe matne si të doni. Po mirë, ata s'e kanë idenë, po sot na i nxitim ata, edhe po thom mos u konë ma mirë me e pas edhe ni hartë që... ku është kjo parcel, se s'po e di unë? Unë p'e shoh që është zona dytë – Plavë, unë dy shkronja i di kryetar, ama qetu p'e shoh veç fletën poseduese, po nuk po e shoh në cilën pjesë...po të lutem, veç zona e dytë – Plavë, unë zonën e dytë të Plavës nuk e di a bjer kah Breznja, a ka Buqja, kah Rrenci a ku është ajo, është mirë me na sjellë ni hartë edhe me pru.

**Uran Halimi:** Faleminderit, Artan! Ni sqarim kryetari p'e jep.

**Bexhet Xheladini:** Ju materialin e keni, edhe këtu janë 14 njësi kadastrale, edhe është fjala te Plava, qysh i thojnë Dubravë, a qysh i thojnë asaj pjesës? Ato pjesë deri më tash i kanë shfrytëzue qytetarët, kanë kullot delet, kanë kullot lopët. Edhe kjo kne edhe ane, është edhe një pjesë pyll aty...

**Uran Halimi:** Më lejoni të jau sqaroj, me numër të parcelës në gjeoportali mundeni me verifikue qetash, veç e shënoni në gjeoportali numrin e parcelës që u janë dërgue këtu, edhe është shumë e thjeshtë me verifikue. Angazhohnu pakës, mos pritni hazër!

**Bexhet Xheladini:** E thajë kush e ka zbulue, e kanë zbulue ata që dojnë me punue.

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër a do me pyet diçka? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, mu po më pëlqen, komunës po i rritet hapësira, kemi bo hala tokë, profesori Nexhë, si gjeograf, e shtish te ajo shifra sa hektarë kemi tokë bujqësore. Unë mendova masi gjetëm tokë për panele solare. Sidoqoftë, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro këtij propozimit që me marrë këtë tokën? Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka. Atëherë knstatoj që me 21 vota pro, me zero kundër edhe zero abstenim, kalon pika e katërt e rendit të ditës. Po ju kërkoj 15 minuta paузë edhe po kthehem prapë në seancë. Po po dalin ka njo ka njo përherë, nja 15 minuta po dalim krejt edhe po kthehna në seancë. Qetësohna pak. 15 ju lutem 15, ta respektojmë, deri në ora tre...

Të nderuar delegatë, po vazhdojmë aty ku mbetëm. Është fjala për pikë numër pesë, Propozim-vendim për emërimin e Komisionit për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Nëse do dikush me e marrë fjalën, nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë Komision? Nëse jo, këtu i kemi veç dy anëtarë, i paskna mundësitë edhe dy anëtarë të Kuvendit m’i propozue, edhe ni përfaqësues i OJQ-së. Kush i thotë këta emra, ju lutem? Me siguri ekzekutivi. Po më thonë që legjislativi e ka të drejtën. Unë e di që propozimet bëhen zakonisht prej partive ma të mëdha, domethënë grupeve ma të mëdha parlamentare. Në këtë rast, grupin ma të madh parlamentar cila e ka, PDK-ja a? E ftoj shefin e juaj qe me e dhonë ni emër...atëherë e ftoj përfaqësuesin e PDK-së që me e dhonë ni emër, nëse kanë interesim.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! Pasi që veç m’u dha mundësia edhe besoj që edhe ligjërisht kemi të drejtë ta japim një emër në këtë Komision, ne po e propozojmë nga grupi i PDK-së profin Nexhat Selaj, nëse nuk ka kundër natyrisht.

**Uran Halimi:** Faleminderit, i nderuar! Qetash te anëtari me numër katër e ftoj LDK-në që me e dhonë ni propozim të tyne. Është mirë me bo anëtare po thojnë...anëtare a, po anëtare e paskni ju me e bo.

**Naser Myrtezani:** Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar i Komunës, përshëndetje për të gjithë! Ne propozojmë Mehmet Spahiun. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Jo anëtare, anëtare...më falni po kongra gabim drejtshkrimor. Gabim teknik është. Atëherë dy anëtarë të propozuar nga dy partitë më të mëdha parlamentare në këtë Kuvend janë Nexhat Selaj nga PDK dhe z.Mehmet Spahiu nga LDK. Për hari ju koftë juve dyve! Vazhdojmë e qesim në votim. Kush është pro themelimit të...okej, hajde kush po na jep ni propozim për anëtarin e OJQ-së?

**Naser Myrtezani:** Faleminderit! Atëherë ne propozojmë Jeton Qengaj. Faleminderit!

**Uran Halimi:** E pranon ai, a po? Faleminderit edhe ni herë! Te anëtari ose përfaqësuesi i OJQ-së është propozuar z.Jeton Qengaj nga OJQ ‘Avoko’. Ta qesim në votim ni herë, veç ni minutë. Hajde, ni minutë. Qetaj thotë na keni diskriminue.

**Nedžmidin Sejdilar:** Pyetja ime do të ishte për partnerët e koalicionit të partisë në pushtet, a mendoni se nuk jemi të diskriminuar nga një komision i tillë. Tre anëtarë, të tre anëtarë nga komuniteti shumicë. Dëshironi t’i thoni diçka zotit Rahte? Ndoshta keni një sugjerim tjetër.

**Uran Halimi:** Ni sekond, veç pak. Islam Redzeplari është anëtar i parë edhe përfaqësues i komunitetit joshumicë. Njëshin e kemi komunitetin joshumicë. Unë s’po besoj që ka diskriminim. Fjalën e ka kërkue z.Jonuzi, ni minutë të lutem, se po e vazhdojmë pak si ma shpejt.

**Munir Jonuzi:** Respekt për të gjithë, çfarë mendoni ju zoti Kryesues që ne nuk kemi diskriminim, kemi diskriminim. Një në pesë, kjo është 20%. Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2011, komuniteti joshumicë përbën 40%, nëse kemi vetëm një anëtar, a është ky diskriminim apo jo, mendoj se është.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Jonuzi! Fjalën e ka kërkue z.Samidin Xheladini.

**Samidin Xheladini:** S’është problem kjo, mundim me e shtue numrin. Pa pagesë janë, vullnetarë, p’i shtojmë edhe dy.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Xheladini, për propozimin tuaj! Atëherë kur ka propozime, na duhet me qit në vota. Edhe z.Xheladini ka propozue që numri i anëtarëve të rritet nga 5 në 7, a? Domethënë i kemi edhe dy vende të lira. E pyeta Ademin, ta kqyrim qetash çka po na thotë. A është fiks? Është fiks, a? Atëherë, më fal z.Xheladini, është numri fiks. Shkojmë në votim. OJQ duhet me pas, se është UA, nuk është dëshirë. Mundni ju si LDK me propozue një, si të jeni zemërmirë, me ndërrue anëtarin. Ni minutë p'e lyp.

**Nedžmidin Sejdilar:** Të nderuar, duhet të keni parasysh se në komunën e Dragashit ekzistojnë tre komunitete. Dhe kur të formohet ndonjë komision, ai duhet të shpërndahet në përqindje që të përfshihen të tria komunitetet. Në komunën e Dragashit kemi një komunitet shumicë shqiptare, dhe një komunitet minoritar goran dhe boshnjak. Është detyrimi juaj që të krijoni një balancë në komisione. Dhe imi është këtu për t'u flas kundër diskriminimi të tillë, dhe ju duhet të planifikoni se si ta bëni atë.

**Uran Halimi:** Faleminderit! Unë e di që këtu ka parti që kanë koalicion, mundin me zgjidhë këta që janë në koalicion ndërmjet veti, edhe me propozue, nëse e shihni si diskriminim. Sidoqoftë, meqenëse neve na saktëson numrin e anëtarëve, emrat u thanë, e qesim në votim vendim-propozimin për themelimin e këtij Komisionit. Kush është pro këtij Komisioni? Kush është kundër këtij Komisioni? Abstenim? Nuk ka. Konstatoj që me 21 vota pro, me 2 kundër edhe zero abstenim, kalon pika e pestë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e gjashtë, është Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të patundshmërisë komunale, parcela me numër 7060403800244-2 në zonën kadastrale në Shajne I. Kush do me e marrë fjalën edhe me diskutue... ta shohim a kemi pyetje. Është e drejtë e saj, edhe e juaja. Jo bre jo, mos u merr me këtë çështje, jemi t'u marrë me pikën e gjashtë, në eventuale flasim. Ej, jemi t'u diskutue për pikën e gjashtë të rendit të ditës, e jo për konflikte interesi. Në eventuale i zgjidhim këto, nëse keni diçka me shtue ma risi, na jemi t'u folë për pikën e gjashtë të rendit të ditës. Munden shefi i Grupit të PDK-së me e njoftue, nëse e sheh të nevojshme, unë hiç s'po e shoh të nevojshme me e diskutue qet çështje. Mirë që ka dalë. Okej, fjalën e ka kërkuë z.Artan Loshaj, si përfaqësues i Grupit Parlamentar...po jemi t'o diskutue për pikën e gjashtë bre, o Artan. Eh, okej.

**Artan Loshaj:** Për pikën e gjashtë, po çka thashë unë. Po tash, zotni drejtor, pse na qite pak në lajthitje, na sot e kemi pikën e gjashtë pa emër, a po, NN. Na po e japim pronën komunale afatgjate, parcelën, qetash nuk po shoh unë, dje e kam bo këtë debat me kryetarin, pse bre po boni kësi sende? Dje e kemi diskutue në Komitet, parcela do të jipet në ankand publik. Pse me dalë ajo jashtë me asi...po vetë drejtori yt po fol, o kryetar, qysh s'e ka ditë, ai p'e di shumë mirë...jo jo, ju lutem, a ka mundësi, unë e diskutoj...po pse bre sa herë unë po foli po ju pengoj juve? Sa herë po folni ju s'po ju pengoj. Zotni drejtor, kthe bre fjalën prapë, se po bini ndesh me kryetarin, mirrnu vesh....

**Uran Halimi:** O Artan, më fal, po jozyrtarisht ka folë...

**Artan Loshaj:** Po qe unë zyrtarisht po foli, me protokol po foli. Po pse bre vajzën e asishni? Mirrnu vesh herën tjetër me drejtorin, edhe kryetari...qeshtu morë le të vjen, po s'është konflikt interesi, po s'jem t'u tut or ju, mos u tutni, ju mos u tutni, unë s'jem t'u tut. Na do ta japim ni parcelë në ankand publik, për 35 vjet, edhe kanë me konkurue njerëzit, ishala s'konkuron korkush,

ishalla konkurron kush ka me konkurrenca edhe ka me marrë. Pse bre po boni qesi sende? Drejtor, pak u ngute qetu, po tërhiqi fjalët.

**Uran Halimi:** Faleminderit! Dikush tjetër a do me diskutue në lidhje me pikën e gjashtë, jo me drejtorin, as me personin paraprak që e përmendet. Po vazhdojmë edhe p'ë hedhim në votim, meqenëse s'ka lyp fjalë kërkush. Kush është pro këtij propozim-vendimi? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 25 vota pro, me zero kundër edhe zero abstenim, kalon pika e gjashtë. Vazhdojmë me pikën e shtatë edhe të fundit, është pika eventuale. Kush do me e marrë fjalën me bo ndonjë pyetje, ndonjë diskutim në lidhje me pikën eventuale, mundeni me e marrë fjalën. Ka kërkue fjalën Artan Loshaj, pas tij fjalën e ka z.Shpetim Hajredini, pas z.Shpetim Hajredini fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdirar dhe pastaj Miralem Rahte.

**Artan Loshaj:** Faleminderit shumë! I nderuar kryetar, masi jemi në eventuale, ti e dish shumë mirë që na dy e shterrim debatin në Komitet, edhe mos me qenë na dy Komiteti nuk mahet. Po dje bre s'mora përgjigje për qata doktorat qatje që punojnë në QKMF, ata specialistat. A ka mundësi para asambleistëve me na kallxue sa e kanë pagën, sa e kanë kontratën, edhe për sa vjet i kanë, edhe a kemi të drejtë a jo m'i pas. Është publike, se dje më thatë nuk është publike paga. Paga e një asambleistit është 588 euro bruto, paga e kryeministrit dihet, paga e secilit dihet, pse bre mos me e dijtë na pagën sa e kanë ata mjekë. Është mirë që i ke pru, është mirë që ju ke bo nder qytetarëve, po veç po due me dijtë, është ni OJQ që i keni 186 mijë euro, edhe është mirë me e dijtë sa paguhen ata. Edhe thaje që do të bie edhe kardiolog, edhe do të bie edhe gjinekolog, është mirë se gjinekologun e kemi, të thashë edhe dje, unë s'e di pse s'keni bo kontratë me të, e kemi gjinekologun ma të mirë të mundshëm në regjion ku jetojmë na këtu. Edhe është mirë se kemi ma shumë nevojë, ma shumë për gjinekolog, se për neuropsikiatër. Po është mirë me doktorin, mos ta përmendi me emër se nashta s'ka qef, është mirë me e bo ni marrëveshje me të... shumë në rregull, po qat pagën, sa e ka pagën, edhe sa është marrëveshja, a është gjashtë muaj, a ni muaj, a ni vjet a. S'është kurgjo kryetar. Qytetarët po pyesin, vallahe më kanë shkruar prom e pyete kryetarin, po s'morrëm përgjigje, qetash më shkruen hajt bre edhe ni herë pyete mos po kallxon. Edhe e dyta është që atë ditë në seancë nuk... edhe me ni seancë që ke qenë këtu prezent dhe që të ka akuzue PDK, edhe që ke rrëfye këtu që, je arsytue për Dubain, ku ishte ai muhabeti. Edhe dje ta thashë edhe sot po të thom, qe edhe doktorin ku e kemi të specializimit, është mirë mjekja në fjalë që e keni marrë në punë, mirë, që shkon në specializim dhe do të na kthehet neve për shërbim për qytetarët tonë. Ke bo shumë mirë. Po unë nuk e di si, pesë vite ajo do të merr rrogë dhe ni ditë të vetme nuk do të vjen në QKMF me punue dhe m'u njoftue me stafin, m'u njoftue me qytetarët, me e dijtë kush është, me e dijtë çfarë mjekë po na vjen, pak me e dijtë qytetarët... unë e di që...doktori është këtu, edhe shkon e jep kujdestari, bare ni herë në muajit le të vjen bre ni të premtë a ni të shtunë në kujdestari këtu, se dje po më thu nuk...për mjekësi familjare po foli, për mjekësi familjare i kemi pas të gjithë, unë po të foli për shëndetin primar, në shëndetin primar kemi edhe mjekë të cilët punojnë dhe janë në specializim, po kontributin vijnë e japin, se kemi mungesë të mjekëve, doktori, kryetari, thotë që nuk kemi mungesë të mjekëve, unë po ju them që kemi mungesë të mjekëve. Çdo specialist në mjekësinë familjare, që shkon në specializime, vjen e jep kontributin, s'është e thënë me e ngarkue tri ose katër kujdestari, po ni kujdestari të vetme



është mirë me qenë këtu. Jo, ka ardhë nga buxheti i komunës me konkurs, i paguhet kujdestaria, është mirë m'i bo shërbim asaj edhe pak m'u aftësue me këto... nuk jam kundër thashë, është mirë që ke bo, bravo të koftë, po është mirë m'u bo pak transparent, se goja plot kur keni ardhë në pushtet, transparencë, transparencë, bone transparente pagën e mjekëve sa e kanë.

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! Nuk do ta zgjas shumë. I nderuar kryetar, kam një pyetje direkt për ju, çka është t'u ndodhë më projektet e fshatit Kuk, nëse kie informacione, keni kontaktue me kompanitë, do të fillojnë, pasi ato janë trivjeçare, janë në vitin e tretë tash, vitin përfundimtar. A kie deni informacion prej pronarëve të kompanive, do të fillojnë si shpejt apo nuk do të fillojnë fare hiç? Nëse kie informacion, mund të më japësh përgjigje, nëse jo, atëherë kurdo që të kie informata prej tyre, në seancat e radhës mujsh me ma dhonë përgjigjen.

**Miralem Rahte:** Respekt, pershendetje te gjithëve. Zoti Kryesues, nuk hezitoj kur të përgjigjem, por ju duket se keni frikë të shikoni në atë drejtim pasi është Kryetari ne ate ane, ndaj nuk më shihni kur të ngre dorën. E dyta: Lajmërohëm për qështjen e fshatit Brod, ju e dini që rruga për në fshatin Brod është duke u rindërtuar. Ka gati dy vjet që fshatarët janë të pakënaqur. Rruga është në gjendje katastrofike. Dua ta pyes Kryetarin, edhe pse e di që nuk bëhet nga buxheti i komunës por nga ministria, por ende duhet një koordinim. Ajo kompani është totalisht jo serioze, atë rrugë e punon ne menyrë totalisht joserioze. Ne si komunë dhe si kuvend duhet të marrim disa masa lidhur me ndërtimin e asaj rruge.

**Uran Halimi:** Qe po ta jap përgjigjen menjëherë, se ishte ni pyetje për mu. Sa i përket frikës, kështu për me kqyrë, koalicionin e keni shumë të dobët, i frikësohem ni koalicioni as ane as ane, kryetarit me iu frikësue s'kam arsye, në asnjë aspekt, frikë s'ekziston te unë. Edhe përgjigjen e rrugës po ta jap, s'është pjesë e komunës ajo, s'është në kompetencë të komunës, është e Ministrisë së infrastrukturës. Çka me të dhënë përgjigje kryetari, ti e dish shumë mirë që MI e ka atë rrugë. Hiç s't'u tuta qetash. Po vazhdojmë, fjalën e ka z.Sejdilar.

**Nedžmidin Sejdilar:** Z. Kryetar, nuk e di si nuk e kuptoni që koalicioni qeverisës është mësuar të fusë frikë dhe zoti Rahte tha atë që tha për atë praktikë, por nuk ka rëndësi, nuk është aq e rëndësishme. Këtu kam probleme shumë më të mëdha se a do të na fusë frikën apo jo koalicioni qeverisës. Zoti Kryetar, ju kujtohet që isha në zyrën tuaj dhe kërkova të riparoja dëmin e asaj zonje kur po ndërtohej parku i qytetit. Ka kaluar shumë kohë, nuk e di nëse e dini dhe nuk e di kush ka qenë organi mbikëqyrës që ka marrë ato punime. Unë personalisht kam qenë atje me atë zonjë dhe ajo zonjë përballet me probleme të mëdha kur bie shi, kur bie borë, për shkak të atij parku atje që po punohej. Në shtëpinë e saj hyjnë sasi të mëdha uji dhe ajo ka probleme të mëdha dhe ju keni detyrimin ta zgjidhni me operatorin ekonomik. Nuk e di se kush ka qenë autoriteti mbikëqyrës që ka pranuar punë të tilla. Të paktën të sanksiononi dhe ndëshkoni në njëfarë mënyre organe të tilla mbikëqyrëse, që të mos ndodhin më. Në përputhje me rregulloren, ju drejtohem si kreu i pushtetit ekzekutiv, por është humane, dinjitoze dhe politikisht korrekte të më dëgjoni dhe të degjoni çfal unë flas. Një nga sfidat me të cilat përballemi është problemi i qenve endacakë. Ju ndoshta nuk jetoni në Dragash dhe nuk e hasni këtë problem, por janë shfaqur një numër i madh i qenve endacakë. Qytetarët nuk mund të dalin në këmbë në orët e vona të mbrëmjes. Ne e dimë që kuvendi ka marrë vendim që ata qentë të mos vriten, si do ta zgjidhni

atë problem, bisedoni me drejtorët tuaj dhe përpiquni ta zgjidhni atë problem sa më shpejt. Gjëja e tretë që duhet ta përmend publikisht, ne kemi pasur 17 komitete të komunitetit deri më tani dhe nga të gjitha ato 17 komitete komunitetit, ju si nikoqir i kësaj shtëpie keni marrë pjesë vetëm në tre komisione komunitetit derisa e keni zgjidhur problemin e nënkryetarit të komunitetit. Pas kësaj nuk ju pashë më në komitetin e komunitetit. Ju lutemi tregoni se kjo shtëpi është një komunitet për të gjithë dhe tregojeni atë me përgatitjet tuaja personale. Unë dua që të gjithë të jetojmë këtu në harmoni, megjithatë administrata juaj me shpërthime të ndryshme çdo ditë kontribuon në aktualizimin e këtyre problemeve. Pak më parë: pushteti juaj ekzekutiv krijoi një komision ku ne nga komunitetet joshumicë ishim të diskriminuar. Ju duhet t'i kushtoni vëmendje këtyre gjërave, keni kërkuar vota njëlloj si në Gorë ashtu edhe në Opojë. Ju kërkoj të na respektoni, të mos na diskriminoni dhe të gjeni vetë një zgjidhje se si të formoni ato komisione ku do të vendoset barazia.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdilar! Fjalën e ka z.Jetmir Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje edhe ni herë! Kisha ni pyetje për drejtorin e Shëndetësisë, po sot nuk është prezent, atëherë po ia bëjmë pyetjen kryetarit edhe kushdo që është i ekzekutivit këtu. Kemi shqetësimin e qytetarëve se Ambulanta në Bresanë nuk punon vikendeve edhe festave. Deri para se me dalë doktor Feta në pension ka punue, të shtunave kemi pas mjek, momentalisht nuk punon. E dimë shumë mirë që qendra ma e afërt për me marrë shërbime shëndetësore është urgjenca e Dragashit, largësia është e madhe, kështu që ni urgjencë me e pas secili banor i Opojës, nuk ka ku e merr ni shërbim shëndetësor. Çfarë keni bo në këtë drejtim, a do të ketë mjek vikendeve edhe festave në QMF në Bresanë, për arsye se veç qat qendër e kemi ma funksionale edhe ma të madhe pak, kështu që është mirë me e gjet ni zgjidhje edhe me na njoftue neve edhe qytetarëve kur ka me fillue me dhonë shërbime edhe vikendeve edhe festave. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ajdini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Mundish kryetar me iu dhënë përgjigje pyetjeve.

**Bexhet Xheladini:** Sa i përket mjekëve specialistë, të cilët janë angazhues në QKMF, do të thotë mjeku i syve dhe neuropsikiatri. Ne në fillim kemi patur plan që të angazhojmë katër mjekë, neuropsikiatrin, oftamologun, gjinekologun edhe internistin kardiolog. Mirëpo, posa filluen ata me punue, ju e dini se erdh ni komision prej Inspektoriatit të Shëndetësisë, edhe e pru ni vendim edhe jau u ndaloj punën këtyre doktorave. Atëherë na jemi ankue, edhe në momentin kur na kanë pru atë vendim ata edhe na kanë ndalue punën e këtyre doktorave, na atëherë nuk kemi mujt me i fillue procedurat me i angazhues edhe dy mjekët tjerë. Kemi prit, na jemi ankue, unë personalisht kam bo ankesë si kryetar i komunës, edhe para disa dite e kemi marrë ni vendim ku është hedhë poshtë vendimi i ISH për ndalimin e punës së këtyre mjekëve dhe na është dhonë e drejta që ata mjekë mund të vazhdojnë të punojnë. Kështu që, di e kam marrë atë vendim, menjëherë jam angazhues që t'i plotësojmë edhe ato dy kërkesa, internistin kardiolog edhe gjinekologun. Prej dy majit, nëse si thotë populli është kismet, ata do të fillojnë punën, edhe gjinekologu do të punojë katër orë në ditë, do të fillojë punën nga ora 09:00-13:00 për çdo ditë, kurse internisti kardiolog do të punojë sikur këta doktorët tjerë, ni herë në javë. Shërbimet qytetarët do t'i kenë pa pagesë, kurse mjekët për punën e tyre që e bëjnë paguhen, e kanë pagën, nuk e kanë pagën e keqe, mirëpo ligji mu nuk

ma lejon që unë të tregoj këtu sa paguhen. Kështu që, ata të cilët janë të interesuet me e dijtë sa e marrin ata pagën, mujn me i pyet personalisht ata, ti i kishe edhe të njoftshëm, kishe muhabet, pyeti personalisht, ata le të tregojnë, unë s'kam të drejtë me tregue. Po nëse gjoish diku mjekë që punojnë ma lirë se këta, bjeri, unë i he kata, i bie ata të tutë. Jo jo, po pagesa që po thuesh, nëse gjoish ma lirë, bjeri. Sa i përket specializantes së gjinekologjisë, së pari është pranue me konkurs si mjeke e rregullt e QKMF-Dragash. Pastaj asaj janë nda specializim, është marrë vendimi, është bo ni kontratë me to që t'i paguhet specializimi, me kusht që për aq vjet sa t'i pagujmë pare, ajo ka me i shërbye kësaj popullate si specialiste e gjinekologjisë. Nëse ajo për shembull, në momentin kur të diplomon, edhe i mushet mendja s'vjen, ka me kthye pagën që e ka marrë në momentin sa ka me qenë pagan ë momentin kur ajo e lëshon punën. Dhe sa i përket kujdestarisë, ajo kujdestaron atje, në klinikë në Prishtinë, dhe tash ajo është edhe nënë, edhe tash nuk ka llogari me ardhë edhe këtu me kujdestarue. Po de, po atje kujdestaron me specialista tjerë. Po unë muj me e thirr në telefon me pyet, nashta vjen ni herë në muj, nuk e di, po nuk muj me e detyrue, se në kontratë nuk shkruan që ajo është e obligume me ardhë me kujdestarue për dy herë në javë, ka mundësi që ka qenë ndonjë lëshim i joni që s'ia kemi shkruar në kontratë. Sa i përket pyetjes së Shpetimit për punët që kanë m'u krye, dy punë ma të mëdhaja që janë t'u bo, kontrata është dy-tri vjeçare. Mbikëqyrësin e punimeve e kam autorizue me ra në kontakt me këta punëkryes edhe ai ka ra në kontakt para se me ra bora, ata kanë thënë që deri në qershor kanë me i krye, fjala e tyre është. Rrugën e Brodit, vërtet rruga e Brodit është katastrofë, nuk është kompetencë e jona, po populli është i joni, rruga është e jonë, territory është i joni. Kryesues, unë të kisha lut ty që, bashkë me mu, na kemi edhe ni punë tjetër te zëvendësministri me krye, edhe me e caktue ni takim apostafat, mujm edhe mas orarit të punës me shkue, m'u takue edhe me diskutue edhe çështjen e rrugës së Brodit, se me të vërtet aty është t'u u punue sikur breshka qysh ecën. Vërtet unë e kam ni respekt shumë të veçantë edhe kam shumë fjalë të mira për zëvendësministrin e Infrastrukturës, është ni njeri jashtëzakonisht i mirë, e kam vërejt që është i pritshëm, ni njeri i kulturuet edhe neve si komunë na ka ndihmue, edhe na ka lëshue edhe mjete, edhe sa herë e thirri unë në telefon, ai veç dy herë si të bjer zilja ai e çel. Ministrat tjerë nuk e çelin, çoi emaila sa të duesh nuk i çelin. Kështu që mirë është na me shkue, e bëjmë edhe ni bisedë, ia tregojmë rastin edhe ka mundësi që dhezën. Z.Sejdilar, për ujin ke të drejtë plotësisht, i është bërë dem asaj, po nuk është faji i punëkryesit. Është faji që ka pëlçit gypi në thellësi dy metra a ni metër e gjys a sa është, edhe s'ka pas shancë për shembull aty që t'u punue me u dëmtue gypi. Po unë sot kam bisedue me këtë shefin e Njësisë regjionale që është këtu në Dragash, edhe i kam dhënë urdhër këtë problem me e zgjidhë, në bashkëpunim me mu edhe me punëkryesin. Punëkryesi ka me e hap gropën, ai ka me e sanue rrjedhën e gypit. Për qentë endacakë nuk kam përgjigje, qentë endacakë ligji nuk na lejon as m'i kap m'i çue diku, as nuk na lejon m'i myt. Ligji thotë me i kastrue edhe me i lonë prapë aty ku janë. Unë kur kam qenë kryeshef i Ekzekutivit, atëherë na është lejue me i myt, kemi shpallë tender, i kanë vra gjuetarët, nuk ka qenë mirë, po atëherë na është lejue, tash është ndërrue ligji, edhe është nime gjynah që i kemi myt, është gjynah m'i myt edhe nuk bon m'i myt, po duhet me gjet sikur Prishtina qysh e ka bo, me ndërtue ni vend, edhe me marrë m'i izolue, m'i çue m'i mbyllë. Te Komiteti për Komunitete unë çdo herë e delegoj nënkryetarin, në KPF marr pjesë vetë,

se po kam angazhime, kryetari kur është i zënë e çon nënkryetarin, por në të ardhmen do të kem kujdes që të marr pjesë, po jo çdo herë. Edhe doktori e ka bo ni pyetje për në Bresanë. Me ligj QMF-të kanë të drejtë, i kanë të kufizuara shërbimet edhe në ligj shkruan që çfarë shërbime mund të ofrojë çdo QMF. QMF-ja e Bresanës punon me dy ndërrime, ka dy herë mjekë, paradite dhe masdite, stomatology paradite e masdite, punon laboratorit etj. Këto janë shërbime ekstra, ligji këtë nuk e lejon, por ne i kemi bo, unë i kam bo kur kam qenë kryeshef edhe është vazhdue ajo, edhe pushteti i kaluet e ka vazhdue të njëjtën, pastak kam marrë iniciativë që do të punohet edhe të shtunën, derisa ka dalë doktor Fetia në pension është punue të shtunën, tash me shkuarjen e tij është mungesë e mjekëve, po unë do të bisedoj me drejtorin e QKMF-së, me pa a ka mundësi të shtunën, të dillën nuk ka mundësi. Me ligj, çdo QKMF duhet me ofruer shërbime 24 orëshe, QKMF-ja jonë i ofron ato, ne nuk jemi të obliguet me ligj, moralisht nashta kemi obligime, po me ligj nuk kemi. Kështu që kjo është pyetje me vend edhe është propozim me vend, po mundësitë qysh janë nuk e di, do t'i shohim. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryetar! E kemi edhe ka ni minutë replikë unë edhe Nedžmidin Sejdlari edhe Miralemi. Po përgjigjem unë i pari...okej.

**Nedžmidin Sejdlar:** Qe koleg, po ta plotësoj dëshirën, nuk është problem, mos e llogarit minutën, prej qetaj në qoftë se mundesh. Kryetar, kështu, për punën e pagës gabim jeni. Sepse me ligjet e Republikës së Kosovës secili qytetar duhet me ditë sa e pagun ni shërbim. Komplet Kosova e di sa i kemi na pagat, sa i keni ju pagat, sa i kanë në spital pagat. Pse ju duhet me i fshehë pagat e këtyre mjekëve karshi qytetarëve të Dragashit? Me ligj e keni obligim m'i tregu qytetarit sa po shpenzoni për shërbimet që ata mjekë po i ofrojnë qytetarit. Do të thotë ju jeni gabim këtu. Edhe kërkoj prej jush me dalë këtu në foltore, me na tregue neve karshi qytetarit, sa po i pagujmë na qata mjekët. Se qytetari ka të drejtë me ditë. Edhe ata mjekët paguhen prej pareve publike, nuk paguhen prej pareve private. Këtu në Republikën e Kosovës edhe rrogat private dihet sa janë, se ekzistojnë ATK-ja, ekzistojnë tatimet, ligjet. Pse vetëm qata mjekët që i keni punësu ju në Dragash m'u konë të privilegjum? E dyta, për qata qentë që folëm, na e kemi obligim me bo diçka për me e mbrojt qytetarin, se janë shumë ata qenë, edhe janë të egër, tepër të egër janë. Po sulmojnë edhe veturat, jo njerëz këmbësorë që shkojnë. Do të thotë, nuk mundesh ti kryetar me dalë këtu me na thonë s'kam përgjigje. Na duhet me gjet deni mënyrë me mbrojt qytetarin. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdlar! z. Rahte e ka fjalën.

**Miralem Rahte:** Dua të falënderoj zotin Kryetar, i cili ishte në ministri vitin e kaluar me kolegët e tij të ekzekutivit dhe do të doja të bëj një propozim. Nuk është e drejte te shkosh ne ministri me nje njeri qe qesh me fatkeqesine e te tjereve, mendoj se nuk është e drejte, por meqenese është per nje fshat nga komuniteti jo shumice, me mire do ishte te shkosh me nënkryetari nga komuniteti joshumicë. Nuk është bukur të qeshësh me fatkeqësinë e dikujt tjetër.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Rahte! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Sa i përket, veç pak para se me e mbyllë seancën, ju kërkoj juve delegatë me qëndruer edhe pak mas mbylljes së seancës, kemi ni çështje për me diskutue vetëm ne legjislacioni. Sa i përket asaj kërkesës që ma boni kryetari, e di që i kam thonë edhe në fillim të mandatit, si kryesues i Kuvendit Komunal, që jam i gatshëm me i shërbye këtij komuniteti, pa dallim etnie ose feje, edhe jam i gatshëm, do ta bëjmë,

kam kërkuar në realitet në takim me zëvendësministrin, na e patën caktuar muajin e kaluar bashkë ditën e seancës, edhe s'kemi mujt me shkue. Kërkoja takim të dytë, s'ishte mirë me shëndet, do ta kemi në takim në të ardhmen. Sa i përket asaj që me kë shkollon kryetari, unë s'besoj që Miralemit i jep llogari në lidhje me këtë. Arsyeja pse shkollon kryetari me kryesuesin është se vitin e kaluar, kur kemi qenë në takim na me kryetarin, i kemi sjellë komunës ku ti jetojsh Miralem edhe votuesit e tu, ia kemi sjellë mbi 640 mijë euro memorandum bashkëpunimi me të njëjtin zëvendësministër. Unë i qeshi atyre gjykimeve tua që i kish shumë të pabaza edhe mjaft qesharake. Faleminderit shumë, me lutjen që jau bona për me qëndruar në seancë...është mirë me nejt krejt, se duhet me marrë mbase ndonjë vendim. E mbyllim këtë seancë, vazhdojmë edhe pak na, vetëm asambleistët. Ju lus mediave edhe ekzekutivit që të lëshojnë sallën. Shihemi në seancat e radhës!

***Kryesuesi i Kuvendit: Uran Halimi***

---